



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 217

Tiranë – E hënë, 14 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 105/2016 datë 27.10.2016	Për mbrojtjen e bimëve..... 22733
Ligj nr. 106/2016 datë 27.10.2016	Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre..... 22742
Ligj nr. 107/2016 datë 27.10.2016	Për prefektin e qarkut..... 22758
Rezolutë e Kuvendit datë 3.11.2016	Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut..... 22764



LIGJ
Nr. 105/2016

PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të mbrojë bimët dhe produktet bimore nga parazitët;
- b) të parandalojë hyrjen dhe përhapjen e parazitëve në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) të mbrojë shëndetin e njerëzve, kafshëve, si dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ambalazh i produkteve për mbrojtjen e bimëve” është çdo material që shërben për ambalazhimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve të një kontejneri, një pako, përfshirë edhe materialet në kontakt me produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB).

2. “Ambalazhimi i PMB-ve” është pjesë e procesit të prodhimit të PMB-ve dhe që ka të bëjë me vendosjen, paraprakisht, të PMB-ve në një ambalazh. Ambalazhimi përfshin edhe etiketimin e PMB-ve, i bërë sipas kërkesave të përcaktuara për etiketimin dhe hedhjen në treg të tyre.

3. “Bimë” janë bimët e gjalla ose pjesë të tyre të gjalla, përfshirë farërat dhe germoplazmën.

4. “Certifikatë fitosanitare e brendshme” është një dokument zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve i zonës nga ku është prodhuar, i cili deklaron që bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera janë kontrolluar zyrtarisht në vendin

e origjinës dhe janë gjetur të pastra nga parazitët karantinorë. Ajo shpreh gjendjen fitosanitare të një ngarkese që plotëson standardet e sigurisë fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5. “Certifikatë fitosanitare për eksport” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve i zonës nga ku është prodhuar, i cili tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, produkteve bimore me rrezik dhe objekteve të tjera plotësojnë standardet e sigurisë fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

6. “Certifikatë për riekport” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve për dërgesat që riekportohen, pasi inspektimet zyrtare kanë siguruar se në dërgesën e re nuk ka rreziqe fitosanitare.

7. “Certifikim fitosanitar i materialit shumëzues” është një procedurë ku bimët mëmë, kandidatet për dhënie të materialit shumëzues, kalojnë nëpër analiza dhe, kur është e nevojshme, në trajtim të veçantë, për të siguruar pastërtinë fitosanitare nga viruset dhe organizmat e tjerë të ngjashëm me ta.

8. “Certifikatë fitosanitare” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve nga vendi i origjinës ose vendi prodhues, i cili tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, produkteve bimore me rrezik dhe objekteve të tjera plotësojnë standardet e sigurisë fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

9. “Gjurmim” është aftësia për të gjurmuar dhe ndjekur një bimë, prodhim bimor me rrezik, objekt tjetër ose produkt për mbrojtjen e bimëve, që janë ose priten të jenë të lidhura me shëndetin e bimëve në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes.

10. “Inspektim” është shqyrtimi pamor i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, i kryer nga inspektori për të përcaktuar nëse ato janë të infektuara ose të prekura me parazitë dhe nëse ato janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me ligjin “Për inspektimin”.

11. “Inspektor” është inspektori i mbrojtjes së bimëve pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

12. “Karantinë bimore” është tërësia e masave parandaluese, të marra me qëllim parandalimin e hyrjes dhe/ose përhapjes së një paraziti karantinor.



13. “Kontroll i integruar” është përdorimi racional i disa metodave biologjike, bioteknologjike, kimike, kulture ose të seleksionimit bimor, me anë të të cilave përdorimi i PMB-ve kufizohet në minimumin e kërkuar për të mbajtur parazitët në nivele të ulëta, të tilla që mënjanojnë provokimin e dëmeve ose humbjeve me pasoja ekonomike.

14. “Laborator i akredituar” është laborator i që ka kaluar me sukses procedurën e akreditimit nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm evropian akreditimi për të kryer ekzaminime dhe analiza të përcaktuara.

15. “Laborator i miratuar i kontrollit” është laborator i miratuar nga ministri për kryerjen e tipave të analizave, të përcaktuara sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji.

16. “Laboratori Kombëtar i Referencës” është laborator, i cili mbikëqyr laboratorët e tjerë në vend për aplikimin e standardeve dhe të metodave të kontrollit laboratorik, përpunimin e kampioneve standarde të referencës dhe kryerjen e ekzaminimeve ndërlaboratorike.

17. “Ligji i inspektimit” është ligji nr. 10 433, datë 16.6.2012, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

18. “Masa të veçanta kontrolli” është një tërësi masash karantine, kimike, agroteknike etj., që ndërmerren në rastet e shtimit e të përhapjes masive të parazitëve dhe që synojnë në uljen e infeksionit në nivelin e dëmit ekonomik apo në çrrënjosjen e plotë të tyre.

19. “Mbetje të PMB-së” është një ose më shumë lëndë vepruese të pranishme në bimë, produkte me origjinë bimore dhe me origjinë shtazore, në ujë të pijshëm ose gjetkë në mjedis, si rrjedhojë e përdorimit të PMB-së, përfshirë këtu edhe metabolitet dhe produktet që dalin nga shpërbërja e tyre.

20. “Ministër” është ministri që mbulon fushën e bujqësisë.

21. “Ministria” është ministria që mbulon fushën e bujqësisë.

22. “Objekte të tjera” është çdo vend ruajtjeje, mjet transporti, kontejner, tokë, organizma të gjallë etj., që shërbejnë për strehimin ose përhapjen e parazitëve.

23. “Parazit” është dëmtuesi, sëmundja dhe barërat e këqija, të dëmshme ose potencialisht të dëmshme për bimët dhe produktet bimore.

24. “Parazit karantinor” është paraziti i rrezikshëm, me ndikim të rëndësishëm ekonomik, që nuk është vërejtur ose është vërejtur në vendin tonë, por nuk është i përhapur gjerësisht.

25. “Pasaportë bimore” është dokumenti shoqërues për lëvizjen në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë të bimëve, si dhe të produkteve bimore me rrezik, të cilat kalojnë në zonat e pastra.

26. “Përdorues i fundit” është personi ose subjekti, i cili përdor PMB.

27. “Përdorues profesionist” është personi, i cili është pajisur me diplomë universitare në fushën e agronomisë, ose i cili i është nënshtruar një trajnimi të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve helmuese ose shumë helmuese dhe është pajisur me dëshmi aftësie ose dëshmi aftësie të veçantë për përdorimin e PMB-ve.

28. “Produkt për mbrojtjen e bimëve” ose “PMB” është produkti, i cili përmban një ose më shumë lëndë vepruese dhe i cili përdoret për mbrojtjen e bimëve e të produkteve bimore nga parazitët ose për parandalimin e veprimit të tyre, për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, por me veprim të ndryshëm nga plehrat kimike, si p.sh. rregullatorët e rritjes, për të shkatërruar bimët e padëshirueshme apo pjesët bimore, si dhe për të mbajtur nën kontroll ose për të parandaluar rritjen e pjesëve bimore të padëshirueshme.

29. “PMB i rrezikshëm” është PMB-ja, e cila përmban njërin nga këto cilësi: eksploziv, oksidues, i ndezshëm, i dëmshëm, gërryes, irritant, i ndjeshëm, kancerogjen, mutagjen, helmues për riprodhimin dhe i rrezikshëm për mjedisin.

30. “PMB me rrezik të lartë” është PMB-ja, e cila përmban njërin nga këto cilësi: shumë helmues (të klasës 1a ose T+), helmues (të klasës 1b ose T), ekstremisht i ndezshëm.

31. “Praktikat e mira të mbrojtjes së bimëve” është tërësia e masave dhe e veprimeve për kontrollin e parazitëve me metodat kimike, duke respektuar kushtet në të cilat PMB-të janë regjistruar, si: respektimi i kufijve kritikë, zgjedhja e dozës dhe volumit, koha dhe numri i trajtimeve, mbrojtja e entomofaunës natyrale dhe mjedisit, si dhe kujdesi për shëndetin e përdoruesve e të konsumatorëve.

32. “Prekje ose infeksion” është prania e parazitëve të gjallë në bimë, në produkte bimore ose në objekte të tjera.



33. “Produkt bimor” është materiali me origjinë bimore, i përpunuar ose jo, i cili mund të përbëjë rrezik për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve e të parazitëve karantinorë.

34. “Regjistrim” është procesi i vlerësimit të një PMB-je, sipas kritereve të vendosura në dispozitat e këtij ligji dhe në aktet nënligjore të dalta në zbatim të tij, si rezultat i të cilit lejohet tregtimi apo përdorimi i tij në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe bëhet pajisja e tij me dokumentet e regjistrimit.

35. “Rieksport” është ngarkesë e rieksportuar pa rënë ndesh me përcaktimet e legjislacionit doganor, e cila është importuar nga një shtet e më pas eksportohet pa u ekspozuar ndaj infektiveve ose kontaminimeve nga parazitët edhe nëse ngarkesa ruhet, ndahet, kombinohet me ngarkesa të tjera ose i ndryshohet ambalazhi.

36. “Specialist i shërbimit të mbrojtjes së bimëve” është specialisti pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, “DRB”, me funksione në fushën e mbrojtjes së bimëve.

37. “Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve” ose “SPMB” është drejtoria që mbulon mbrojtjen e bimëve në ministri.

38. “Trajtim” është procedura e autorizuar për ngordhjen, largimin ose kufizimin e parazitëve.

39. “Tregtim i PMB-ve” është çdo aktivitet, i cili lidhet me magazinimin, shpërndarjen, prezantimin për shitje ose shitjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të PMB-ve të regjistruara.

40. “Zonë” është një territor ose pjesë e një territori, që i përket një ose më shumë fshatrave, bashkive ose qarqeve.

41. “Zonë e pastër” është një territor ose pjesë e një territori, që i përket një ose më shumë fshatrave, bashkive ose qarqeve, të pastër nga parazitë të caktuar.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES SË BIMËVE

Neni 3

Strukturat e mbrojtjes së bimëve

Strukturat e mbrojtjes së bimëve, të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji, janë:

- a) struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB) në ministri;
- b) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);

c) shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë drejtorive rajonale të bujqësisë (DRB);

ç) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);

d) Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) pranë ISUV-it.

Neni 4

Detyrat e strukturave të mbrojtjes së bimëve

1. Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve ka këto detyra:

a) është autoriteti kompetent që harton politikat e mbrojtjes së bimëve dhe për përshtatjen e legjislacionit të mbrojtjes së bimëve me atë të BE-së;

b) zhvillon procedurat që lidhen me regjistrimin e PMB-ve, të lëndëve vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve;

c) ndjek dhe zbaton aktivitetin e shërbimit në kuadër të mbrojtjes së bimëve në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është organi inspektues, i cili ka detyrë kontrollin e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si dhe të akteve të tjera ligjore në fushën e inspektiveve.

3. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së ka detyrë monitorimin e gjendjes fitosanitare të bimëve, produkteve bimore dhe të objekteve të tjera brenda territorit në administrim të tyre.

4. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë ka detyrat e përcaktuara sipas pikave 1.2 dhe 2, të nenit 5, të këtij ligji.

5. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve ka detyrat e përcaktuara sipas pikave 1.1 dhe 2, të nenit 5, të këtij ligji.

Neni 5

Laboratorët kombëtarë të referencës

1. Laboratorë kombëtarë të referencës janë:

1.1. Laboratorët e diagnostikimit të parazitëve, pranë DMB-së, të cilët kanë për detyrë:

a) të monitorojnë parazitët karantinorë, të përcaktojnë statusin e tyre, metodat e kontrollit karantinor dhe të njoftojnë ministrinë;

b) të bëjnë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e parazitëve, duke përcaktuar edhe masat e kontrollit të tyre;



c) të bëjnë provat biologjike-agronomike të PMB-ve gjatë procedurës për regjistrimin e tyre, kur kërkohet një gjë e tillë.

1.2. Laboratori i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe ai i mbetjeve të tyre në bimët e në produktet me origjinë bimore, pranë ISUV-it, i cili ka për detyrë:

a) vlerësimin e dokumentacionit të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;

b) kontrollin cilësor të PMB-ve të regjistruara dhe të hedhura në treg;

c) analizën e mbetjeve të PMB-ve në bimët dhe produktet me origjinë bimore, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të legjislacionit për sigurinë ushqimore.

2. Krahas detyrave të përcaktuara në pikat 1.1 dhe 1.2, të pikës 1, të këtij neni, laboratorët kombëtarë të referencës kryejnë detyrat e mëposhtme, sipas fushës së tyre të përcaktimit:

a) vlerësimin e laboratorëve, me qëllim miratimin e tyre si laboratorë të miratuar për kryerjen e analizave të kontrolleve zyrtare;

b) bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes, përfshirë trajnimet dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;

c) organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara dhe marrjen pjesë në to në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të miratuar të kontrollit;

ç) garantimin e përdorimit të një sistemi të brendshëm, në përputhje me standardet e kërkuara nga laboratorët e miratuar të kontrollit.

Neni 6

Laboratorët e miratuar të kontrollit

1. Laboratorët rajonalë të mbrojtjes së bimëve në varësi të ministrisë janë laboratorë të miratuar kontrolli. Laboratorë të kontrollit të mbrojtjes së bimëve mund të miratohen edhe laboratorë të tjerë, publikë apo privatë, të akredituar.

2. Kriteret e përgjithshme dhe procedurat për miratimin e laboratorëve të kontrollit të mbrojtjes së bimëve hartohen nga laboratorët kombëtarë të referencës dhe miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Laboratorët e kontrollit miratohen me urdhër të ministrit, pas vlerësimit të kryer nga laboratorët kombëtarë të referencës për përmbushjen e kriterëve, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe sipas llojit të analizave për të cilat janë akredituar.

4. Tarifat e shërbimeve dhe të analizave, që kryhen nga laboratorët kombëtarë të referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU III

KONTROLLI I PARAZITËVE

Neni 7

Detyrimi për kontrollin e parazitëve dhe pajisja me “Certifikatë fitosanitare”

1. Personat fizikë dhe juridikë, që kultivojnë, prodhojnë, përpunojnë, magazinonë dhe tregtojnë bimë dhe produkte bimore, janë të detyruar:

a) të marrin masa paraprake kundër parazitëve dhe të parandalojnë shumëzimin e përhapjen e tyre, sipas praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve;

b) të veprojnë bimësinë, tokën dhe produktet bimore për shfaqjen e parazitëve dhe t'i kontrollojnë ato, në bazë të praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve dhe të kriterëve të mbrojtjes së integruar.

2. Çdo bimë ose produkt bimor, i aftë për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëviz brenda territorit të vendit, duhet t'i nënshtrohet kontrollit fitosanitar dhe duhet të pajiset me “Certifikatë fitosanitare të brendshme”, të lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së, ose “Pasaportë bimore”, lëshuar nga prodhues të autorizuar. Kushtet dhe kriteret për autorizimin e prodhuesve të bimëve dhe produkteve bimore përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Në rastet e lëvizjes së bimëve ose produkteve bimore jashtë territorit të vendit, ato duhet t'i nënshtrohen kontrollit fitosanitar dhe të pajisen me “Certifikatën fitosanitare për eksport”, të lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së.

4. Në rastin e hyrjes në territorin e vendit të bimëve ose të produkteve bimore, për qëllim rieksporti dhe qëndrimit të tyre brenda vendit për më shumë se 14 ditë, atëherë ato duhet t'i nënshtrohen kontrollit fitosanitar dhe duhet të pajisen edhe me “Certifikatën fitosanitare për riekport”, të lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së.

5. Sasi të vogla të bimëve, produkteve bimore, për qëllime të konsumit vetjak ose përdorim personal, për përdorim joindustrial, bujqësor apo tregtar, mund të qarkullojnë në vend edhe kur nuk



shoqërohen me “Certifikatë fitosanitare” ose “Pasaportë bimore”, me kusht që të mos përbëjnë rrezik për përhapjen e organizmave të dëmshëm.

6. Kultivimi, prodhimi, shumëzimi, magazinimi, përpunimi dhe tregtimi i bimëve të infektuara me parazitë karantinorë janë të ndaluar.

7. Rregullat e praktikave të mbrojtjes së bimëve, si dhe hartimi i praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve dhe i kriterëve të mbrojtjes së integruar hartohen nga DMB-të dhe miratohen me urdhër të ministrit, me propozim të SPMB-së.

Neni 8

Masat e veçanta të kontrollit të parazitëve

1. Masat e veçanta për rastet emergjente të përhapjes e të shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit, si dhe mobilizimi për këtë qëllim i subjekteve shtetërore e private, të cilat zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore e materiale, përcaktohen me urdhër të ministrit.

2. Shpenzimet për masat e veçanta në këto raste përballohen nga buxheti vjetor i ministrit.

3. Rregullat në lidhje me masat e veçanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 9

Pastërtia fitosanitare e materialit shumëzues dhe mbjellës bimor

1. Materialet bimore për shumëzim ose mbjellje lejohen të përdoren vetëm pasi i janë nënshtruar kontrollit fitosanitar dhe janë pajisur me “Certifikatë fitosanitare”.

2. Speciet drufrutore dhe hardhia, të cilat shtohen në mënyrë vegetative, i nënshtrohen procedurës së certifikimit të materialit shumëzues për të siguruar pastërtinë nga viruset dhe organizma të tjerë, të ngjashëm me to.

Neni 10

Zonat e pastra

1. Në zonat e pastra nuk lejohet prania e një ose më shumë prej parazitëve karantinorë për të garantuar pastërtinë fitosanitare nga këta parazitë.

2. Miratimi i njohjes së “zonës së pastër” bëhet me urdhër të ministrit.

3. Rregullat për njohjen e zonave të pastra përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 11

Kërkesat fitosanitare ndaj paletave dhe materialit të ambalazhit prej druri

1. Materiali i ambalazhit dhe i paletave prej druri u nënshtrohet masave të miratuara fitosanitare për qëllime dezinfektimi.

2. Materiali i ambalazhit dhe i paletave prej druri duhet të përmbajë vulën përkatëse që tregon trajtimin e tij sipas masave të miratuara.

3. Materiali i ambalazhit dhe i paletave prej druri, që shoqëron çdo ngarkesë, është objekt i inspektimit fitosanitar në pikat e kalimit kufitar edhe kur ngarkesa nuk është subjekt i inspektimit fitosanitar.

4. Rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 12

Pasaporta bimore

1. Lëvizja e bimëve ose e produkteve bimore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet edhe duke i shoqëruar ato me “Pasaportë bimore”, e cila është një dokument i lëshuar nga prodhuesi i autorizuar. SPMB-ja verifikon plotësimin e kushteve dhe të kriterëve për lëshimin e “Pasaportës bimore” nga prodhuesit e autorizuar.

2. “Pasaporta bimore” dëshmon se prodhuesi i autorizuar ka përmbushur standardet e shëndetit të bimëve dhe të sigurisë fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për bimët dhe produktet bimore të prodhuara prej tij.

3. Procedurat, kushtet dhe kriteret për pajisjen me “Pasaportë bimore” përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 13

Fondet për mbrojtjen e bimëve

1. Fondet e veçanta për mbrojtjen nga parazitët të bimëve të kultivuara apo spontane planifikohen në buxhetin vjetor që miratohet për ministrinë.

2. Përcaktimi i parazitëve, për kontrollin e të cilëve do të përdoret ky fond, miratohet me urdhër të ministrit.

3. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, miraton shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve financiare të mbrojtjes së bimëve.



KREU IV
SHËRBIMI DHE INSPEKTIMI
KARANTINOR FITOSANTAR

Neni 14

Detyrimi për inspektim karantinor fitosanitar

1. Importi, eksporti dhe kalimi transit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera bëhen në pikat doganore të hyrjes, ku funksionon inspektimi karantinor fitosanitar, dhe i nënshtrohen këtij inspektimi.

2. Importi, eksporti dhe kalimi transit i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera bëhen vetëm nëse ato janë të pajisura me “Certifikatën fitosanitare” si dhe nëse ambalazhet e paletat prej druri janë të trajtuara.

3. Importi, eksporti dhe kalimi transit i bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, të infektuara me parazitë karantinore, janë të ndaluar.

4. Inspektori është pjesë e grupit të praktikës doganore, që merr kontaktin e parë me mjetet që transportojnë bimë, produkte bimore, PMB dhe objekte të tjera.

5. Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 15

Njoftimi i shërbimit të mbrojtjes së bimëve

1. Personat fizikë dhe juridikë, që merren me kultivimin, prodhimin, transportin, tregtimin dhe magazinimin e bimëve e të produkteve bimore, kur vërejnë ose dyshojnë për një parazit të pahasur më parë në një zonë ose për shtim masiv të një paraziti, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë shërbimin e mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së dhe AKU-në, si dhe të sigurojnë një mostër të tij.

2. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve, pas përcaktimit të parregullsisë apo parazitit, njofton shërbimin e mbrojtjes së bimëve të vendit të origjinës.

3. Rregullat për mënyrën e njoftimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 16

Shpallja e zonës së prekur

1. Kur në një zonë shfaqet një parazit karantinor, shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së njofton menjëherë SPMB-në.

2. Me marrjen e njoftimit, SPMB-ja përgatit masat për kufizimin e përhapjes së parazitit karantinor deri në çrrënjosjen e tij në zonën përkatëse dhe i propozon ministrit miratimin e këtyre masave, si dhe shpalljen e kësaj zone si zonë e prekur.

3. Urdhri i ministrit u njoftohet organeve të qeverisjes vendore dhe prodhuesve, personave fizikë e juridikë, që merren me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve e të produkteve bimore.

Neni 17

Shumëzimi i parazitëve për qëllime kërkimore

1. Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve karantinorë për qëllime kërkimore dhe eksperimentale, lejohet në rast se institucioni kërkimor zotëron mjetet e nevojshme, që garantojnë me protokoll të veçantë mospërhapjen e parazitit karantinor.

2. Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve karantinorë, sipas pikës 1, të këtij neni, nga institucionet kërkimore lejohen vetëm me urdhër të ministrit.

Neni 18

Eksporti

1. Eksporti i bimëve dhe i produkteve bimore lejohen nëse:

a) ngarkesa është me origjinë nga Republika e Shqipërisë para lëshimit të “Certifikatës fitosanitare për eksport” dhe shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së ka kryer kontrollin, për të siguruar nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

b) ngarkesat, që do të eksportohen, nuk janë me origjinë nga Republika e Shqipërisë, por janë magazinuar, ripaketuar apo ndarë në Republikën e Shqipërisë dhe para lëshimit të certifikatave për riekспорт, shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë DRB-së ka kryer kontrollin për të siguruar nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat fitosanitare, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. “Certifikata fitosanitare për riekспорт” konsiderohet dokument zyrtar, kur inspektori fitosanitar vërteton se përmbushen kërkesat, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni.



3. Formati dhe përmbajtja e certifikatave fitosanitare për eksport dhe riekспорт, janë pjesë e rregullave për inspektimin karantinor fitosanitar, të përcaktuara sipas pikës 5, të nenit 14, të këtij ligji.

KREU V PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 19 Regjistrimi

1. Të gjitha PMB-të që tregtohen ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.

2. Në Republikën e Shqipërisë regjistrohen vetëm PMB-të, të cilat janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit European.

3. Të gjitha procedurat, që lidhen me regjistrimin e PMB-ve, lëndëve vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve kryhen në ministri, pranë SPMB-së, si autoriteti përgjegjës.

4. Rregullat e regjistrimit, procedura dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

5. Miratimi i lëndëve vepruese, i përbërësve të tjerë në përmbajtje të PMB-ve, i të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, si dhe përditësimi i tyre, në përputhje me legjislacionin e BE-së, bëhen me urdhër të ministrit.

Neni 20 Tregtimi i PMB-ve

1. Lejohet tregtimi me shumicë dhe me pakicë i PMB-ve të regjistruara.

2. Tregtimi me shumicë dhe pakicë i PMB-ve bëhet nga persona fizikë, të diplomuar në fushën e agronomisë, ose nga persona juridikë, të cilët duhet të punësojnë një ose disa persona, teknikë përgjegjës, të cilët janë diplomuar në këtë fushë.

3. Tregtia e PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i PMB-ve me rrezik dhe i PMB-ve me rrezik të lartë kryhet me licencë, të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit, në zbatim të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Ministri, me propozimin e AKU-së, mund të pezullojë dhe/apo të revokojë licencën, në

përputhje me pikën 3, të këtij neni, në rastet kur nuk përmbushen më kriteret e dhënies së licencës apo shkelen detyrimet e përcaktuara në të, si dhe në rastet kur ka një rrezik serioz për shëndetin publik dhe është e nevojshme e urgjente marrja e masave parandaluese.

5. Në njësitë e tregtimit me shumicë të PMB-ve ndalohet:

a) mbajtja dhe tregtimi i PMB-ve me ambalazhe të pamiratuara;

b) asgjësimi i ambalazheve dhe i PMB-ve të skaduara apo të dëmtuara;

c) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz e për kafshë, si dhe i farërave të padezinfektuara, që mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë si: drithëra, bishtajore për kokërr (bizele, bathë, fasule);

ç) riambalazhimi i PMB-ve;

d) shitja e PMB-ve me pakicë të përdoruesi i fundit.

6. Në njësitë e tregtimit me pakicë ndalohet:

a) shitja e PMB-ve helmuese të personat, që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie, si dhe e PMB-ve shumë helmuese të personat që nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 23, të këtij ligji;

b) shitja e PMB-ve helmuese dhe shumë helmuese pa recetë;

c) mbajtja dhe tregtimi i PMB-ve me ambalazhe të pamiratuara;

ç) asgjësimi i ambalazheve dhe i PMB-ve të skaduara apo të dëmtuara;

d) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe për kafshë, si dhe i farërave të padezinfektuara, që mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë, si: drithëra, bishtajore për kokërr (bizele, bathë, fasule);

dh) riambalazhimi i PMB-ve.

7. Rregullat për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e PMB-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 21

Tregtimi i materialit mbjellës, të dezinfektuar

1. Lejohet tregtimi i materialit mbjellës, të dezinfektuar me një PMB, e cila është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të BE-së.



2. Etiketa dhe dokumentet shoqëruese për materialin mbjellës, të dezinfektuar, duhet të përfshijnë emrin tregtar të PMB-së dhe emrin ose emrat e lëndës ose lëndëve vepruese në përmbajtje të saj.

Neni 22

Transporti dhe ruajtja e PMB-ve

1. Transporti i PMB-ve kryhet me mjete të sigurta dhe të përshtatshme, sipas legjislacionit në fuqi për mallrat dhe substancat e rrezikshme.

2. PMB-të ruhen në magazina në rastin e tregtimit me shumicë, si dhe në mjediset e tregtimit me pakicë.

3. Kushtet në magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të PMB-ve, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketën e PMB-ve.

4. Magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve duhet të jenë të pajisura me:

a) mjetet e nevojshme për asgjësimin e PMB-ve të rrjedhura;

b) këndin e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;

c) pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;

ç) mjediset higjieno-shëndetësore me ujë të rrjedhshëm;

d) magazinat të jenë të pajisura me sistemet e ajrimit, si dhe aparatet matëse dhe regjistruese të temperaturës e të lagështirës së ajrit, si dhe mjediset veçanta qëndrimi për punonjësit e tyre.

Neni 23

Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve

1. Përdorimi i qëndrueshëm i PMB-ve duhet të sigurojë uljen e rreziqeve dhe ndikimeve të tyre në shëndetin e përdoruesve, konsumatorëve, kafshëve dhe mjedisit si dhe kontrollin e integruar të parazitëve.

2. PMB-të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në dokumentin e regjistrimit të tyre.

3. PMB-të shumë helmuese përdoren vetëm nga përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimi të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve shumë të rrezikshme dhe janë pajisur me dëshmi aftësie të veçantë për këtë përdorim.

4. PMB-të helmuese përdoren nga përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose nga persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimi të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve helmuese dhe janë pajisur me dëshmi aftësie për këtë përdorim.

5. Trajtimet me PMB duhet të kryhen me mjete dhe makineri sipas legjislacionit në fuqi për makineritë, legjislacionit që përfshin dhe makineritë për përdorim të PMB-ve, për të garantuar sigurinë e shëndetit të përdoruesve, të mjedisit dhe të bimëve e të produkteve bimore ku ato përdoren.

6. Rregullat për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve, si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

7. Kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me PMB, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 24

Ambalazhimi i PMB-ve

1. Lejohet ambalazhimi i PMB-ve, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

2. Ambalazhimi i PMB-ve përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ambalazhimi i PMB-ve kryhet nga subjekte të licencuara sipas kërkesave të legjislacionit në zbatim të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Licencimi kryhet bazuar në verifikimin paraprak nga AKU-ja të kushteve e të kriterëve të caktuara për këtë qëllim në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Rregullat e përgjithshme për klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve zbatohen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve. Rregullat specifike për ambalazhimin dhe etiketimin e PMB-ve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 25

Asgjësimi i PMB-ve dhe ambalazheve të tyre

1. PMB-të, ambalazhet dhe materialet e tjera, që duhet të asgjësohen, janë:



a) PMB-të e papërdorshme, për shkak të skadimit ose për arsye të tjera, përjashtuar rastet kur ato i janë nënshtruar analizave nga laboratorit i akredituar dhe parametrat e tyre janë të njëjta me ato të dosjes së regjistrimit;

b) PMB-të që kanë rrjedhur gjatë ruajtjes e transportit dhe materialet e përdorura për thithjen e dezaktivizimin e tyre;

c) ambalazhet, si: fuçi, bidonë, shishe, kuti, qese dhe objekte të tjera të ngjashme, të boshatisura;

ç) sendet e ndotura gjatë punës, si: pajisje mbrojtëse, enë të ndryshme, mjete pastrimi, objekte të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të përdoren më.

2. Tregtuesit me shumicë të PMB-ve, për PMB-të e përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, janë të detyruar t'i largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë ose të bëjnë djegien (inçinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit.

3. Asgjësimi i PMB-ve me djegie (inçinerim), brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

4. Ministri, së bashku me ministrin përgjegjës për mjedisin, miratojnë udhëzimin për asgjësimin e PMB-ve dhe të ambalazheve të tyre, sipas përcaktimeve të shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

5. Riciklimi i ambalazheve të PMB-ve, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të kryhet vetëm për ato ambalazhe, të cilat nuk janë të kontaminuara me PMB të klasifikuara si PMB të rrezikshme dhe PMB me rrezik të lartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetje.

6. Ambalazhet e kontaminuara me PMB të klasifikuara si PMB të rrezikshme dhe PMB me rrezik të lartë duhet të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 26

Të dhënat statistikore për PMB-të

1. Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me ministrinë, të sigurojë të dhënat statistikore të PMB-ve:

a) çdo vit për sasi të hedhura në treg;

b) çdo 5 vjet për sasi të përdorura.

2. Rregullat e sigurimit të të dhënave statistikore të PMB-ve përcaktohen me marrëveshje mirëkuptimi midis Institutit të Statistikave dhe ministrisë.

Neni 27

Kërkesat për gjurmueshmërinë

1. Gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit bimor me rrezik, objekteve të tjera ose PMB-ve, që janë ose priten të jenë të lidhura me shëndetin e bimëve, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së tyre.

2. Prodhuesit e bimëve dhe tregtuesit e PMB-ve krijojnë një sistem për mbajtjen e të dhënave, të quajtur bazë të dhënash, dhe garantojnë procedurat, të cilat mundësojnë identifikimin e tyre në çdo çast. Nëpërmjet këtyre të dhënave bëhet identifikimi i çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar apo është furnizuar me bimë, prodhime bimore me rrezik, objekte të tjera ose PMB.

3. Prodhuesit dhe tregtuesit e bimëve, si dhe tregtuesit e PMB-ve e ruajnë informacionin e përmendur në pikën 2, të këtij neni, për tre vjet dhe ia japin këtë informacion AKU-së dhe ministrit, me kërkesë të tyre.

KREU VI

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 28

Kundërvajtje administrative

1. Kur nuk përbëjnë veprë penale, shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me:

a) gjobë 10 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 1, të nenit 7; pikën 1, të nenit 15; dhe pikat 2, 3 e 5, të nenit 23, të këtij ligji;

b) gjobë 50 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 2, të nenit 7; pikën 1, të nenit 10; nenet 11 e 12; pikën 1, të nenit 14; pikën 1, të nenit 17; dhe pikën 4, të nenit 22, të këtij ligji;

c) gjobë 100 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 2, të nenit 14; nenin 15; pikat 2 e 6, të nenit 20; nenin 21; pikat 2 e 3, të nenit 23; dhe pikën 4, të nenit 24, të këtij ligji;

ç) gjobë 200 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikat 1, 3 e 5, të nenit 20; pikën 3, të nenit 22; pikat 1 e 2, të nenit 24; dhe pikën 3, të nenit 25, të këtij ligji;



d) gjobë 500 000 lekë, si dhe propozim për heqje të licencës përkatëse në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikën 1 të nenit 20; dhe në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji.

Të gjitha të ardhurat nga gjrobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji, të cilat sipas pikës 1, të këtij neni, përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç masës së vënies së gjobës, e cila është dënim kryesor, vendosen edhe dënime plotësuese si masa e kthimit të ngarkesave, e heqjes së licencës, e heqjes së të drejtës së tregtimit me shumicë ose pakicë, si dhe masa urgjente, si masa e bllokimit në rastin e shkeljeve të dispozitave të pikës 2, të nenit 7, dhe të nenit 19, të këtij ligji.

Neni 29

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 28, të këtij ligji, e ka inspektori i organit të kontrollit.

2. Kundër vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim ose ankim i veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

3. Procedura e konstatimit dhe vendosjes do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 30

Dispozitë kalimtare

1. Laboratorët e diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, riorganizohen si institucion në varësi të ministrit.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 14; të pikës 4, të nenit 19; të pikës 7, të nenit 20; të

pikës 6, të nenit 23 dhe pikës 2, të nenit 30, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 6; të pikave 2 e 7, të nenit 7; të pikave 1 e 3, të nenit 8; të pikave 2 e 3, të nenit 10; të pikave 1 e 3, të nenit 12; të pikave 2 e 3, të nenit 13; të pikës 3, të nenit 15; të pikës 2, të nenit 17; të pikës 5, të nenit 19; të pikës 7, të nenit 23; dhe të pikës 4, të nenit 24 të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për mjedisin të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 10, dhe pikës 4, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 32

Shfuqizime

1. Ligji nr. 9362, datë 24.3.2005, “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9362, datë 24.5.2005, “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, i ndryshuar, për aq sa përputhen me ligjin në fuqi.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9839, datë 9.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 106/2016

PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK, ETIKETIMIN E PRODUKTEVE BIOLOGJIKE DHE KONTROLLIN E TYRE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007, datë 28 qershor 2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) 2092/91”, të ndryshuar. Numri CELEX: 32007R0834, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L Nr. 189, dt. 20.7.2007, faqe 1-23.



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit biologjik, të sigurojë funksionimin efikas të tregut dhe të garantojë konkurrencë të drejtë, besimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

2. Ky ligj përcakton objektivat dhe parimet e përgjithshme për:

a) të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes e shpërndarjes së produkteve biologjike dhe kontrollit të tyre;

b) përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit biologjik në etiketim dhe reklama.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për produktet që vijnë nga bujqësia, përfshirë akuakulturën, kur këto produkte janë vendosur ose kanë për qëllim të vendosen në treg, si më poshtë:

a) produktet bujqësore të gjalla ose të papërpunuara;

b) produktet bujqësore të përpunuara për t'u përdorur si ushqim;

c) ushqimet për kafshë;

ç) materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Ky ligj zbatohet edhe për majatë që përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë.

3. Ky ligj zbatohet për çdo operator të prodhimit, përgatitjes, transportit dhe shpërndarjes së produkteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të operatorëve të kateringut.

4. Ky ligj zbatohet për produktet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pa cenuar dispozitat ligjore në fuqi për prodhimin, përgatitjen, tregtimin, etiketimin dhe kontrollin, për ushqimin dhe ushqimin për kafshë.

5. Produktet nga gjuetia dhe peshkimi i kafshëve të egra nuk konsiderohen prodhim biologjik.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Autoriteti kompetent” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.

b) “Akuakulturë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për akuakulturën.

c) “Aditiv ushqimor për ushqime për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

ç) “Etiketim” ka kuptimin e dhënë në aktet nënligjore në zbatim të ligjit për ushqimin.

d) “Fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes” është çdo fazë, duke filluar nga prodhimi primar i një produkti biologjik, deri te ruajtja, përpunimi, prodhimi, transporti dhe shitja apo furnizimi te konsumatori i fundit dhe atje ku është e nevojshme, si edhe veprimtaritë e etiketimit, reklamave, importit, eksportit dhe nënkontraktimeve.

dh) “I prodhuar nga OMGJ” është produkti, i cili vjen tërësisht apo pjesërisht nga OMGJ-të, por që nuk përmban apo përbëhet nga OMGJ-të.

e) “I prodhuar me OMGJ” është produkti i prodhuar duke përdorur një OMGJ, si organizëm i fundit i gjallë në procesin e prodhimit, por që nuk përmban ose përbëhet nga OMGJ-të dhe as është prodhuar nga OMGJ-të.

ë) “Kalim” është kalimi nga bujqësia jobiologjike në biologjike, brenda një periudhe të caktuar kohe, gjatë së cilës zbatohen kërkesat për prodhimin biologjik.

f) “Lëndë ndihmëse e përpunimit” është çdo substancë që nuk konsumohet si përbërës ushqimor në vetvete, e cila përdoret qëllimisht në përpunimin e lëndëve të para, ushqimeve apo përbërësve të tyre, për të arritur një qëllim të caktuar teknologjik gjatë trajtimit ose përpunimit dhe që mund të rezultojë në praninë e paqëllimshme, por teknikisht të pashmangshme, të mbetjeve të vetë substancës ose derivateve të saj në produktin përfundimtar, me kusht që këto mbetje të mos paraqesin rrezik për shëndetin, si dhe të mos kenë ndonjë efekt teknologjik në produktin përfundimtar.

g) “Operator” është çdo person fizik apo juridik, përgjegjës për të siguruar zbatimin e kërkesave të këtij ligji në veprimtaritë biologjike të kontrolluara prej tij.



gj) “Organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ)” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

h) “Prodhim biologjik” është përdorimi i metodave të prodhimit në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj për të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.

i) “Prodhim bimor” është prodhimi i produkteve nga bimët bujqësore, përfshirë vjeljen e bimëve të egra për qëllime tregtare.

j) “Produkt biologjik/organik/bio/eko” është produkt i përfutur ose i lidhur me prodhimin biologjik.

k) “Prodhim shtazor” është prodhimi i kafshëve dhe shpendëve shtëpiake apo të zbutura (përfshirë insektet), përjashtuar kafshët ujore.

l) “Përgatitja” janë veprimet për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve biologjike, përfshirë therjen e kafshëve dhe prerjen e mishit, ambalazhimin, etiketimin dhe/ose ndryshimet e bëra në etiketimin për tregimin e metodës së prodhimit biologjik.

ll) “Paraambalazhim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

m) “Përbërës” ka kuptimin e dhënë në aktet nënligjore në zbatim të ligjit për ushqimin.

n) “Produkte për mbrojtjen e bimëve (PMB)” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

nj) “Produkt i kontaminuar” është produkti që, pas analizimit laboratorik, rezulton me mbetje të inputeve të palejuara për t’u përdorur në prodhimin biologjik ose me çdo mbetje tjetër.

o) “Reklamë” është çdo paraqitje te publiku, me çdo mënyrë tjetër përveç etiketës, që ndikon ose mund të ndikojë dhe përcaktojë qëndrime, bindje e sjellje për të nxitur drejtpërdrejt apo tërthorazi shitjen e produkteve biologjike.

p) “Rrezatim jonizues” është transferim i energjisë në formë grimcash elementare ose valësh elektromagnetike, me gjatësi 100 nanometër apo më të vogël ose me frekuencë 3 x 10¹⁵ Hertz apo më të madhe, në gjendje të prodhojë jone, drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt.

q) “Trupa e kontrollit” është njësi e pavarur private, vendase apo e huaj, e cila kryen inspektimin dhe certifikimin në fushën e prodhimit biologjik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

r) “Ushqim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

rr) “Ushqim për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

s) “Vendosje në treg” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

sh) “Veprimtaritë e kateringut” është përgatitja e produkteve biologjike në restorante, spitale, mensa dhe biznese të tjera të ngjashme ushqimore, në pika shitjeje apo shpërndarjeje për konsumatorin e fundit.

KREU II

OBJEKTIVAT DHE PARIMET E PRODHIMIT BIOLOGJIK

Neni 4

Objektivat

Objektivat për prodhimin biologjik janë:

a) vendosja e një sistemi menaxhimi të qëndrueshëm të bujqësisë, i cili:

i) respekton sistemet dhe ciklet e natyrës, ruan e përmirëson shëndetin e tokës, ujit, bimëve dhe kafshëve, si dhe ekuilibrin ndërmjet tyre;

ii) kontribuon për një nivel të lartë të larmisë biologjike;

iii) siguron përdorimin e përgjegjshëm të energjisë e burimeve natyrore, të tilla si uji, toka, lëndët biologjike dhe ajri;

iv) respekton standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe, në veçanti, plotëson nevojat specifike jetësore, sipas llojeve të kafshëve;

b) prodhimi i produkteve me cilësi të lartë;

c) prodhimi i një larmie të gjerë ushqimesh e produktesh të tjera bujqësore, të cilat i përgjigjen kërkesës së konsumatorëve për produkte të prodhuara nga përdorimi i proceseve që nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njerëzve, bimëve ose shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Prodhimi biologjik mbështetet në këto parime:

a) Planifikimi dhe menaxhimi i përshtatshëm i proceseve biologjike, bazuar në sistemet ekologjike që përdorin burime natyrore brenda sistemit, me metoda, të cilat:

i) përdorin organizma të gjallë dhe metoda mekanike prodhimi;



ii) praktikojnë kultivimin e kulturave bujqësore dhe prodhimin shtazor, të bazuara në tokë, ose akuakulturën, në përputhje me parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm;

iii) përjashtojnë përdorimin e OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ, por nuk përjashtojnë përdorimin e produkteve mjekësore veterinarë;

iv) bazohen në vlerësimin e rrezikut dhe, kur është e nevojshme, në marrjen e masave paraprake dhe parandaluese.

b) Kufizimi i përdorimit të inputeve që vijnë nga jashtë njësisë. Kur inputet e jashtme janë të nevojshme ose nuk ekzistojnë praktikisht dhe metodat e përshtatshme menaxheriale, të përcaktuara në shkronjën “a”, të këtij neni, atëherë ato kufizohen në:

i) inpute nga prodhimi biologjik;

ii) substanca natyrore apo me prejardhje natyrore;

iii) plehra minerale me tretshmëri të ulët.

c) Kufizimi i rreptë i përdorimit të inputeve të sintetizuara kimikisht vetëm në rastet përjashtimore kur:

i) nuk ekzistojnë praktikisht e përshtatshme të menaxhimit;

ii) inputet e jashtme, të përcaktuara në shkronjën “b”, të këtij neni, nuk gjenden në treg;

iii) përdorimi i inputeve të jashtme, të përcaktuara në shkronjën “b”, çon në krijimin e efekteve të papranueshme mjedisore.

ç) Përshtatja, kur është e nevojshme dhe brenda përcaktimeve të këtij ligji, e rregullave të prodhimit biologjik, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore, ndryshimet klimatike rajonale dhe të kushteve lokale, fazat e zhvillimit, si dhe praktikisht e veçanta të mbarështimit.

Neni 6

Parimet e veçanta për bujqësinë

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, bujqësia biologjike bazohet në këto parime të veçanta:

a) ruajtja, zhvillimi i jetës, pjellorisë natyrore të tokës, qëndrueshmërisë e larmisë biologjike në tokë, duke parandaluar e luftuar erozionin, ngjeshjen e tokës dhe të ushqyerit e bimëve kryesisht përmes ekosistemit të tokës;

b) minimizimi i përdorimit të burimeve të paripërtëritshme dhe të inputeve nga jashtë fermës;

c) riciklimi i mbetjeve dhe nënprodukteve me prejardhje bimore e shtazore si inpute në prodhimin bimor e shtazor;

ç) marrja parasysh e ekuilibrit ekologjik lokal apo rajonal në marrjen e vendimeve për prodhimin;

d) ruajtja e shëndetit të kafshëve, duke nxitur mbrojtjen imunologjike natyrore të tyre, si dhe përzgjedhjen e racave e praktikave të përshtatshme të mbarështimit;

dh) mbrojtja e shëndetit të bimëve nëpërmjet masave parandaluese, siç janë përzgjedhja e specieve të përshtatshme, varieteteve të qëndrueshme ndaj dëmtuesve e sëmundjeve, qarkullimet e përshtatshme të kulturave bujqësore, metodat mekanike e fizike, si dhe mbrojtja e armiqve natyrorë të dëmtuesve;

e) zbatimi i praktikave të prodhimit shtazor që i përshtaten vendit dhe që lidhen me tokën;

ë) sigurimi i një niveli të lartë të mirëqenies së kafshëve, duke respektuar kërkesat e veçanta sipas specieve;

f) prodhimi i produkteve blegtorale biologjike, nga kafshë të rritura në ferma biologjike që nga lindja ose çelja dhe gjatë gjithë jetës së tyre;

g) zgjedhja e racave, bazuar në aftësinë e kafshëve për t'iu përshtatur kushteve lokale, vitalitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre ndaj sëmundjeve ose problemeve shëndetësore;

gj) ushqimi i kafshëve me ushqim biologjik për kafshë, të përbërë nga lëndë të para që vijnë nga bujqësia biologjike dhe nga substanca natyrore jobujqësore;

h) zbatimi i praktikave të mbarështimit të kafshëve, të cilat forcojnë sistemin imunitar dhe fuqizojnë mbrojtjen natyrore kundër sëmundjeve, duke përfshirë, sidomos, ushtrime fizike të rregullta dhe, kur është e përshtatshme, qasjen ndaj vendeve të hapura e në kullota;

i) përjashtimi i mbarështimit të kafshëve poliploide, të krijuara në rrugë artificiale;

j) ruajtja e larmisë biologjike të ekosistemeve natyrore ujore, e shëndetit të vazhdueshëm të mjedisit ujor, e cilësisë së ekosistemeve ujore dhe tokësore përreth tyre, në prodhimin nga akuakultura;

k) ushqimi i organizmave ujorë me ushqim për kafshë që vjen nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit, në mënyrë që popullata ujore të mos ndikohet e të mos ushtrojë ndikim negativ në mjedis, ose me ushqime biologjike për kafshë, të



përbëra nga përbërës bujqësorë biologjikë dhe substanca natyrale jobujqësore.

Neni 7

Parimet e veçanta për përpunimin e ushqimeve biologjike

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, prodhimi i ushqimeve biologjike të përpunuara bazohet në këto parime të veçanta:

a) prodhimi i ushqimeve biologjike nga përbërës që vijnë nga bujqësia biologjike, përveç rasteve kur një përbërës i tillë nuk gjendet në treg në formë biologjike;

b) kufizimi i përdorimit të aditivëve ushqimorë, i përbërësve jobiologjikë, me funksione kryesisht teknologjike e shqisore, si dhe i mikroelementeve e lëndëve ndihmëse në përpunim, në mënyrë që të përdoren në sasi minimale dhe vetëm në rast nevojë të domosdoshme teknologjike ose për qëllime të veçanta ushqimore;

c) përjashtimi i substancave dhe metodave përpunuese që mund të keqinformojnë lidhur me natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi me kujdes i ushqimit, duke i dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

Neni 8

Parimet e veçanta për përpunimin e ushqimeve biologjike për kafshë

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, prodhimi i ushqimeve të përpunuara biologjike për kafshë bazohet në këto parime të veçanta:

a) prodhimi i ushqimeve biologjike për kafshë nga përbërës ushqimorë biologjikë për kafshë, përveçse kur përbërës të tillë nuk gjenden në treg në formë biologjike;

b) kufizimi i përdorimit të aditivëve të ushqimit për kafshë dhe lëndëve ndihmëse për përpunim në sasi minimale dhe vetëm në raste nevojë të domosdoshme teknologjike apo zooteknike ose për qëllime të veçanta të të ushqyerit;

c) përjashtimi i substancave dhe metodave përpunuese që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi me kujdes i ushqimit për kafshë, duke i dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

Faqe | 22746

KREU III RREGULLAT E PRODHIMIT

SEKSIONI 1 NDALIMET NË PRODHIMIN BIOLOGJIK

Neni 9

Ndalimi i përdorimit të OMGJ-ve

1. Në prodhimin biologjik ndalohet përdorimi i OMGJ-ve dhe i produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ, si ushqim, ushqim për kafshë, lëndë ndihmëse në përpunim, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehra të përdorimit bujqësor, përmirësues të tokës, material mbjellës dhe shumëzues bimor, mikroorganizma dhe kafshë.

2. Për qëllim të ndalimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për OMGJ-të ose produktet e prodhuara nga OMGJ-të, si ushqime dhe ushqime për kafshë, operatorët mund të bazohen tek etiketa që shoqëron produktin ose në çdo dokument tjetër shoqëruës, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin, lidhur me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave gjenetiksht të modifikuar dhe gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore dhe ushqimit për kafshë, të prodhuara nga organizmat gjenetiksht të modifikuar.

Operatorët mund të konsiderojnë se asnjë OMGJ ose produkt i prodhuar nga OMGJ-të nuk është përdorur gjatë prodhimit të ushqimeve ose ushqimeve për kafshë, nëse etiketa ose dokumenti shoqëruës nuk tregon që përmban OMGJ, përveç kur ka informacione se etiketimi i produkteve në fjalë nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushqimin.

3. Për ndalimet, sipas pikës 1, të këtij neni, për produktet që nuk janë ushqim ose ushqim për kafshë apo produktet e prodhuara nga OMGJ, operatorët që përdorin produkte të tilla jobiologjike, të blera nga palë të treta, duhet t'i kërkojnë shitësit dokumentacionin që vërteton se produktet e ofruara nuk janë prodhuar nga ose me OMGJ.

4. Masat për ndalimin e përdorimit të OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.



Neni 10

Ndalimi i përdorimit të rrezatimit jonizues

Ndalohet përdorimi i rrezatimit jonizues në trajtimin e ushqimeve biologjike ose ushqimeve biologjike për kafshë, apo të lëndëve të para që përdoren në ushqimet biologjike ose në ushqimet biologjike për kafshë.

SEKSIONI 2
PRODHIMI BUJQËSOR

Neni 11

Rregulla të përgjithshme për prodhimin bujqësor

1. Ferma bujqësore menaxhohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin biologjik.

2. Në kushte të veçanta, ferma mund të ndahet në njësi prodhimi bujqësor ose vende prodhimi të akuakulturës, të ndara qartësisht nga ato të prodhimit jobiologjik. Për kafshët, kjo zbatohet për specie të ndryshme; për akuakulturën mund të përdoren të njëjtat specie, me kusht që të sigurohet ndarje e përshtatshme e vendeve të prodhimit; për bimët, për të shmangur prodhimin paralel, përdoren varietete të ndryshme, lehtësisht të dallueshme.

3. Në përputhje me përcaktimin në pikën 2, të këtij neni, në rastet kur prodhimi biologjik nuk kryhet në të gjitha njësitë e fermës, fermeri e ndan veçmas tokën, kafshët dhe produktet që përdoren për njësitë biologjike, ose që prodhohen nga këto njësi, nga ato që përdoren ose prodhohen nga njësitë jobiologjike, dhe mban dokumentacionin e duhur, që e vërteton këtë ndarje.

Neni 12

Rregullat për prodhimin bimor

1. Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimin bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin biologjik bimor zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

a) për prodhimin biologjik bimor përdoren praktika punimi dhe kultivimi që ruajnë ose rrisin përmbajtjen e lëndës biologjike në tokë, qëndrueshmërinë dhe larminë biologjike të tokës dhe parandalojnë ngjeshjen dhe erozionin e saj;

b) pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës ruhen dhe rriten nëpërmjet qarkullimeve shumëvjeçare të kulturave, përfshirë bimët bishtajore e kultura të

tjera për plehërim të gjelbër, dhe përdorimit të plehut të kafshëve ose materialeve biologjike të përfutuara nga prodhimi biologjik, që të dyja mundësisht të kompostuara;

c) lejohet përdorimi i preparateve biodinamike;

ç) plehrat dhe përmirësuesit e tokës përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji;

d) nuk përdoren plehrat minerale azotike;

dh) të gjitha teknikat e prodhimit bimor të parandalojnë ose minimizojnë mundësinë e ndotjes së mjedisit;

e) parandalimi i dëmit të shkaktuar nga dëmtuesit, sëmundjet dhe barërat e këqija mbështetet, kryesisht, në mbrojtjen me anë të armiqve natyrorë, zgjedhjen e specieve dhe varieteteve, në qarkullimet bujqësore, në teknikat e kultivimit dhe në proceset termike;

ë) në rast të një rreziku real për një kulturë, përdoren vetëm produktet për mbrojtjen e bimëve, sipas përcaktimit në nenin 16, të këtij ligji;

f) për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farat dhe materialit mbjellës e shumëzues bimor përdoret vetëm farë dhe material mbjellës dhe shumëzues bimor i prodhuar në mënyrë biologjike. Për këtë qëllim, bimët mëmë, në rastin e farërave, dhe bimët prindërore, në rastin e materialit shumëzues bimor, prodhohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, për të paktën një brezni, dhe në rastin e kulturave shumëvjeçare, dy cikle vegetative;

g) në prodhimin biologjik bimor përdoren vetëm produktet për pastrim dhe dezinfektim, të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

2. Mbledhja e bimëve të egra dhe pjesëve të tyre, që rriten në mënyrë natyrore në pyje dhe zonat bujqësore, konsiderohet metodë e prodhimit biologjik, me kusht që:

a) këto zona të mos jenë trajtuar me produkte të tjera, përveç atyre të përcaktuara sipas nenit 16, të këtij ligji, për një periudhë, të paktën, trevjeçare para mbledhjes;

b) mbledhja të mos ndikojë në ekuilibrin e habitatit natyror apo ruajtjen e specieve në zonën e mbledhjes dhe të realizohet nëse është në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor.

Neni 13

Rregullat për prodhimin e algave të detit

1. Mbledhja e algave të egra dhe pjesëve të tyre, të cilat rriten në mënyrë natyrore në det,



konsiderohet si një metodë e prodhimit biologjik, me kusht që:

a) zonat e rritjes së tyre të kenë cilësi të larta ekologjike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ujërat dhe cilësinë e ujërave për rritjen e molusqeve që nuk rezultojnë të papërshtatshme nga ana shëndetësore;

b) algat detare natyrore të ngrënshme të mos mblidhen në zona, të cilat nuk plotësojnë kriteret e vendosura për zonat A e B, të përcaktuara në legjislacionin për produktet ujore, në fuqi, për rregullat dhe normat specifike për organizimin e kontrolleve zyrtare të produkteve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor;

c) mbledhja të mos ndikojë në ekuilibrin afatgjatë të mjedisit natyror ose ruajtjen e specieve në zonën e mbledhjes dhe të realizohet nëse është në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor.

2. Kultivimi i algave të detit konsiderohet biologjik kur bëhet në zonat bregdetare me karakteristika mjedisore dhe shëndetësore që janë, të paktën, ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) përdorimin e praktikave të qëndrueshme në të gjitha fazat e prodhimit, që nga mbledhja e algave të reja për kultivim deri te vjelja e tyre;

b) për të siguruar ruajtjen e një rezerve gjenetike me bazë të gjerë, mbledhja e algave të reja të detit në gjendje natyrore bëhet në mënyrë të rregullt, për të furnizuar zonat e kultivimit;

c) nuk përdoren plehurat kimike, përveçse në zonat e kultivimit të brendshëm dhe vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

3. Rregullat e hollësishme për prodhimin bimor dhe prodhimin e algave të detit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 14

Rregullat për prodhimin blegtoral

Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin blegtoral zbatohen edhe këto rregulla:

a) Në lidhje me origjinën e kafshëve:

i) kafshët biologjike të jenë lindur dhe rritur në ferma biologjike;

ii) për qëllim riprodhimi, në një fermë biologjike mund të sillen kafshë të rritura në mënyrë

jobiologjike, por në kushte të veçanta. Kafshë të tilla dhe produktet e tyre mund të konsiderohen biologjike pas plotësimit të periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji.

iii) kafshët e pranishme në fermë prej fillimit të periudhës së kalimit, si dhe produktet e tyre, konsiderohen biologjike pas plotësimit të periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji.

b) Në lidhje me praktikatat e mbarështimit dhe kushtet e strehimit:

i) personeli që kujdeset për kafshët të ketë eksperiencë dhe përvojë minimalisht trevjeçare lidhur me nevojat shëndetësore dhe mirëqenien e kafshëve;

ii) praktikatat e mbarështimit, përfshirë dendësinë e tufës dhe kushtet e vendstrehimit, të sigurojnë plotësimin e nevojave fiziologjike të sjelljes dhe zhvillimit të kafshëve;

iii) kafshët të kenë qasje të përhershme në sipërfaqe të hapura, mundësisht në kullota, sa herë që e lejojnë kushtet klimatike dhe gjendja e tokës, përveç rasteve të kufizimeve dhe detyrimeve të lidhura me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve e kafshëve, të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi;

iv) numri i kafshëve të kufizohet për të minimizuar mbikullotjen, ngjeshjen e tokës, erozionin ose ndotjet e shkaktuara nga kafshët ose nga shpërndarja e plehut të tyre;

v) kafshët biologjike të mbahen të veçuara nga kafshët e tjera, megjithatë, në kushte të caktuara kufizuese, lejohet kullotja e kafshëve biologjike në kullota të përbashkëta dhe e kafshëve jobiologjike në toka biologjike;

vi) ndalohet lidhja apo izolimi i kafshëve, përveçse për kafshë të veçanta, për një periudhë të kufizuar kohe dhe aq kohë sa është e nevojshme për arsye sigurie, mirëqenieje ose arsye veterinare;

vii) kohëzgjatja e transportit të kafshëve duhet të jetë sa më e shkurtër;

viii) gjatë gjithë jetës së tyre, kafshëve u shmangen, sa më shumë të jetë e mundur, çdo lloj vuajtje, përfshirë gjymtimin dhe çastet e therjes;

ix) parqet e bletëve duhet të vendosen në zona që sigurojnë burime të mjaftueshme nektari e pjalmi, kryesisht nga kultura bujqësore biologjike ose, sipas rastit, nga bimësia spontane apo pyje të menaxhuara në mënyrë jobiologjike ose nga kultura



bujqësore të trajtuara vetëm me metoda me ndikim të ulët në mjedis. Këto parqe të mbahen në distancë të mjaftueshme nga burimet që mund të çojnë në ndotjen e produkteve të bletarisë ose të dëmshme për shëndetin e bletëve;

x) zgjojet dhe materialet që përdoren në bletari të jenë të ndërtuara, kryesisht, prej materialeve natyrore;

xi) ndalohet vrasja e bletëve në hoje, si metodë e vjeljes së produkteve të bletarisë.

c) Në lidhje me riprodhimin:

i) riprodhimi duhet të bëhet me metoda natyrore, por lejohet edhe inseminimi artificial;

ii) riprodhimi nuk duhet të nxitet me trajtime me hormone ose me substanca të ngjashme, përveçse në formën e trajtimit kurues veterinar për kafshë të veçanta;

iii) nuk lejohen format e tjera të riprodhimit artificial, si klonimi dhe transferimi embrional;

iv) duhet të zgjidhen raca të përshtatshme, që të kontribuohet në parandalimin e çfarëdo vuajtjeje dhe për të shmangur nevojën për gjymtimin e kafshëve.

ç) Në lidhje me ushqimin për kafshë:

i) ushqimi për kafshë sigurohet, kryesisht, nga vetë ferma ku mbahen kafshët ose nga fermat e tjera biologjike në të njëjtin rajon;

ii) kafshët duhet të ushqehen me ushqim biologjik për kafshë, i cili plotëson kërkesat ushqyese në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre. Një pjesë e racionit ushqimor mund të përmbajë ushqim për kafshë nga ferma që janë në periudhë kalimi drejt bujqësisë biologjike;

iii) me përjashtim të bletëve, kafshët duhet të kenë qasje të përhershme në kullota apo ushqime voluminoze natyrore;

iv) lëndët e para jobiologjike, bimore e shtazore për ushqim për kafshë, dhe ato minerale, aditivët ushqimorë, produkte të caktuara që përdoren në të ushqyerit e kafshëve dhe si ndihmëse në përpunim përdoren vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji;

v) nuk lejohen të përdoren stimulantët e rritjes dhe aminoacidet sintetike;

vi) të vegjlit e gjitarëve duhet të ushqehen me qumësht natyral, mundësisht me qumështin e nënës.

d) Në lidhje me parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimet veterinarë:

i) parandalimi i sëmundjeve bazohet në përzgjedhjen e racave dhe të linjave, në praktikën menaxhuese të mbarështimit, në ushqimin për kafshë me cilësi të lartë dhe në ushtrime, në dendësinë e përshtatshme të tufës, si dhe në kushte strehimi dhe higjienë të përshtatshme;

ii) sëmundja duhet të trajtohet menjëherë, për të shmangur vuajtjet e kafshëve, dhe produktet mjekësore veterinarë alopatiche, të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, përdoren kur është e nevojshme dhe nën kushte të rrepta mbikëqyrjeje dhe në rastet kur përdorimi i produkteve fito-terapeutike, homeopatiche e produkteve të tjera është i papërshtatshëm. Në veçanti, në lidhje me ciklet dhe periudhat e ndërprerjes së trajtimeve, përcaktohen kufizime, sipas legjislacionit në fuqi;

iii) lejohet përdorimi i medikamenteve veterinarë imunizuese;

iv) lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve sipas legjislacionit në fuqi.

dh) Produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve e pajisjeve blegtorale përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji.

Neni 15

Rregullat e prodhimit për speciet nën akuakulturë

Përveç rregullave të përgjithshme për prodhimin bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin e specieve nën akuakulturë zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

a) Për origjinën e specieve të akuakulturës:

i) akuakultura biologjike bazohet në rritjen e pasardhësve të rinj me origjinë nga qendra prindërore biologjike për riprodhim dhe ferma biologjike;

ii) kur nuk mund të sigurohen pasardhësit e rinj nga qendra prindërore apo ferma biologjike, atëherë sillen specie të prodhuara në rrugë jobiologjike, në kushte të përcaktuara.

b) Për praktikën të mbarështimit:

i) personeli që kujdeset për mbarështimin duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë minimalisht trevjeçare, lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e specieve;

ii) praktikën e mbarështimit, përfshirë ushqyerjen, projektimin e instalimeve, dendësinë e kafshëve dhe cilësinë e ujit duhet të sigurojnë



plotësimin e nevojat fiziologjike, zhvillimore dhe të sjelljes së specieve;

iii) praktikat e mbarështimit duhet të minimizojnë ndikimin negativ të fermës në mjedis, përfshirë largimin e specieve nga mjediset e fermës;

iv) speciet biologjike duhet të mbahen të ndara nga speciet e tjera ujore;

v) gjatë transportit duhet të sigurohet ruajtja e mirëqenies së specieve ujore;

vi) duhet të minimizohet çdo vuajtje e specieve, përfshirë edhe momentin e fundit jetësor.

c) Për riprodhimin:

i) nuk përdoren induksioni artificial i poliploidisë, hibridizimi artificial, klonimi dhe prodhimi i individëve njëgjjinorë, përveç zgjedhjes me dorë;

ii) përzgjidhen individë të përshtatshëm;

iii) përcaktohen kushtet specifike sipas specieve, për menaxhimin e qendrave prindërore për shtimin dhe prodhimin e pasardhësve të rinj.

ç) Për ushqimin e peshqve dhe krustaceve:

i) speciet duhet të ushqehen me ushqim që ju plotëson kërkesat ushqimore në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre;

ii) pjesa bimore e ushqimit për kafshë duhet të përftohet nga prodhimi biologjik dhe pjesa e ushqimit për kafshë që përftohet nga speciet ujore duhet të vijë nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit;

iii) lëndët e para jobiologjike me prejardhje bimore, shtazore dhe minerale për ushqim për kafshët, aditivët e ushqimit për kafshë, disa produkte të caktuara që përdoren në të ushqyerit e kafshëve, si dhe ndihmësit në përpunim, përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji;

iv) nuk lejohen të përdoren stimulantët e rritjes dhe aminoacidet sintetike.

d) Për molusqet bivalve dhe speciet e tjera, të cilave nuk u jepet ushqim nga njeriu por ushqehen me plankton natyror:

i) ato specie që ushqehen nëpërmjet filtrimit duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre ushqyese nga natyra, përjashtuar rastin e brezit të ri, të rritur në vaska rritjeje dhe inkubator;

ii) ato duhet të rriten në ujëra që përmbushin kriteret e parashikuara për zonat A dhe B, sipas legjislacionit për produktet ujore në fuqi;

iii) zonat e rritjes duhet të kenë cilësi të lartë ekologjike, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

dh) Për parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimet veterinarë:

i) parandalimi i sëmundjeve bazohet në mbajtjen e specieve në kushte optimale, nëpërmjet vendosjes së përshtatshme, projektimit optimal të fermës, zbatimit të praktikave të mira të mbarështimit dhe menaxhimit, përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt të lokaleve, ushqimin për kafshë me cilësi të lartë, dendësinë e duhur të specieve dhe zgjedhjen e racave dhe linjave;

ii) sëmundja duhet të trajtohet menjëherë, për të shmangur vuajtjen e species. Në rastet kur përdorimi i produkteve fito-terapeutike, homeopatike dhe i produkteve të tjera është i papërshtatshëm, kur është e nevojshme dhe nën kushte të rrepta mund të përdoren produktet alopatiche mjekësore veterinarë të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët. Në mënyrë të veçantë përcaktohen kufizimet lidhur me ciklet e trajtimit dhe periudhat që nuk bëhet trajtim, në zbatim të legjislacionit në fuqi;

iii) lejohet përdorimi i barnave imunizuese veterinarë;

iv) lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, sipas legjislacionit në fuqi.

e) Produktet për pastrim dhe dezinfektim të pellgjeve, kafazeve, ndërtesave dhe pajisjeve përdoren vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

Neni 16

Produktet dhe substancat që përdoren në bujqësinë biologjike dhe kriteret për përdorimin e tyre

1. Në prodhimin biologjik përdoren produktet dhe substancat, sipas një liste të përcaktuar, për këto qëllime:

a) si produkte për mbrojtjen e bimëve;

b) si plehra dhe përmirësues të tokës;

c) si lëndë të para jobiologjike për ushqim për kafshë, të cilat janë me origjinë bimore, shtazore e minerale, dhe substanca të caktuara, që përdoren në ushqyerjen e kafshëve;

ç) si aditivë në ushqimin për kafshë dhe ndihmës në përpunim;

d) si produkte për pastrim dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, ndërtesave dhe pajisjeve për prodhimin shtazor;



dh) si produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe pajisjeve që përdoren në prodhimin bimor, përfshirë edhe ruajtjen në fermën bujqësore.

2. Lista e produkteve dhe substancave, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përdorimi i produkteve dhe substancave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet sipas përcaktimeve në kreun II, si dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta, si më poshtë:

a) përdorimi i tyre është i nevojshëm për prodhimin e qëndrueshëm dhe i domosdoshëm për çfarë synohet;

b) të gjitha produktet dhe substancat janë me origjinë bimore, shtazore, mikrobike, minerale, përveçse kur këto produkte ose substanca, nga burime të tilla, nuk gjenden në sasi të mjaftueshme ose me cilësinë e duhur, si dhe kur nuk gjenden alternativa të tjera;

c) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, zbatohen këto rregulla:

i) përdorimi i tyre është i domosdoshëm për luftimin e organizmave të dëmshëm, të një sëmundjeje të veçantë, për të cilën nuk ka alternativa të tjera biologjike, fizike, ose nga seleksionimi, praktika kultivimi, praktika të tjera menaxhimi të efektshme;

ii) nëse produktet nuk janë me origjinë bimore, shtazore, mikrobike ose minerale dhe nuk janë identike me formën e tyre natyrore, ato mund të përdoren vetëm nëse si kusht për përdorimin e tyre vendoset mënjanimi i çdo kontakti të drejtpërdrejtë me pjesët e ngrënshme të bimës;

ç) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i tyre është i domosdoshëm për të rritur, ruajtur pjellorinë e tokës, përmbushur kërkesat e veçanta të të ushqyerit të bimëve ose për qëllime të veçanta, për përmirësimin e tokës;

d) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, zbatohen këto kërkesa:

i) të jenë të domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të mirëqenies e vitalitetit të kafshëve dhe të kontribuojnë në një dietë të përshtatshme, duke plotësuar nevojat fiziologjike e të sjelljes së specieve në fjalë, ose në rast se këto ushqime për kafshë nuk mund të prodhohen apo ruhen pa përdorimin e

këtyre substancave;

ii) ushqimi për kafshë me prejardhje minerale, oligoelementet, vitaminat ose provitaminat të jenë me origjinë natyrore dhe, në rast se këto substanca nuk mund të sigurohen në prodhimin biologjik, mund të përdoren substanca me efekte kimikisht analoge, të mirëpërcaktuara.

Neni 17

Rregullat për prodhimin në kalim

Feramat, në të cilat ka filluar prodhimi biologjik, duhet të zbatojnë këto rregulla:

a) periudha e kalimit fillon sa më parë, kur operatori ka njoftuar për aktivitetin e tij autoritetin kompetent dhe e ka bërë fermën e tij subjekt të sistemit të kontrollit, në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji;

b) gjatë periudhës së kalimit zbatohen të gjitha rregullat e përcaktuara në këtë ligj;

c) periudhat e kalimit përcaktohen në bazë të llojit të kulturës bujqësore apo prodhimit shtazor;

ç) në një fermë ose njësi pjesërisht me prodhim biologjik dhe pjesërisht me prodhim në kalim drejt prodhimit biologjik, operatori mban të ndara produktet e prodhuara në mënyrë biologjike nga ato në kalim drejt prodhimit biologjik, edhe kafshët mbahen të ndara ose lehtësisht të ndara, dhe mban dokumentacionin përkatës për këtë ndarje;

d) për të përcaktuar periudhën e kalimit, të përmendur më lart, mund të merret parasysh edhe një periudhë përpara datës së fillimit të periudhës së kalimit, nëse mund të vërtetohet prania e kushteve të caktuara;

dh) kafshët dhe produktet shtazore, të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të këtij neni, nuk tregtohen me treguesit për etiketimin dhe reklamën e produkteve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26, të këtij ligji.

Neni 18

Rregulla të hollësishme për prodhimin, përpunimin, ambalazhimin, transportin dhe ruajtjen

Rregullat e hollësishme për prodhimin blegtoral, prodhimin e specieve nën akuakulturë dhe për prodhimin në kalim, sipas neneve 14, 15 e 17, të këtij ligji, dhe rregullat për grumbullimin,



paketimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve organike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

SEKSIONI 3 PRODHIMI I USHQIMEVE TË PËRPUNUARA PËR KAFSHË

Neni 19

Rregullat e përgjithshme për prodhimin e ushqimeve të përpunuara për kafshë

1. Prodhimi i ushqimeve të përpunuara për kafshë bëhet i ndarë në kohë ose hapësira të ndryshme nga prodhimi i ushqimeve të përpunuara jobiologjike për kafshë.

2. Në përbërjen e ushqimeve biologjike për kafshë nuk përzihen lëndë të para ushqimore biologjike apo nga prodhimi në kalim me lëndë të para ushqimore të prodhuara me metoda jobiologjike.

3. Nuk lejohet përdorimi i tretësve të sintetizuar kimikisht në lëndët e para apo në ushqimet e përpunuara për kafshë.

4. Nuk lejohet përdorimi i substancave dhe teknikave për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit e ruajtjes së ushqimeve biologjike për kafshë, ose për të korrigjuar pasoja të pakujdesive gjatë përpunimit apo, nga ana tjetër, që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

SEKSIONI 4 PRODHIMI I USHQIMEVE TË PËRPUNUARA

Neni 20

Rregulla të përgjithshme për prodhimin e ushqimeve të përpunuara

1. Përgatitja e ushqimeve biologjike të përpunuara kryhet e ndarë në kohë ose në hapësira të ndryshme nga ushqimet jobiologjike.

2. Për përbërjen e ushqimeve biologjike të përpunuara plotësohen këto kushte:

a) produkti prodhohet kryesisht nga përbërës me prejardhje bujqësore. Për të përcaktuar nëse produkti është prodhuar kryesisht nga përbërës me prejardhje bujqësore nuk merren parasysh uji dhe kripa e gjellës, që shtohen gjatë përgatitjes;

b) në produktet ushqimore mund të përdoren vetëm aditivë, ndihmës të përpunimit, aromatizues,

ujë, kripë, preparate me bazë mikroorganizmash e enzimash, lëndë minerale, oligoelemente, vitamina, aminoacide e mikrolëndë të tjera ushqyese, që përdoren në ushqime për përdorime të veçanta, vetëm nëse përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji;

c) përbërësit me prejardhje nga bujqësia jobiologjike përdoren vetëm nëse përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji;

ç) një përbërës biologjik nuk duhet të jetë i pranishëm bashkë me të njëjtin përbërës jobiologjik ose një përbërës që vjen nga bujqësia në kalim;

d) ushqimet e prodhuara nga kulturat bujqësore në kalim duhet të përmbajnë vetëm një përbërës bimor me prejardhje bujqësore.

3. Nuk lejohet të përdoren substanca e teknika për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit biologjik ose për të korrigjuar pakujdesi gjatë përpunimit apo, nga ana tjetër, që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

Neni 21

Rregulla të përgjithshme në prodhimin e majave biologjike

1. Për prodhimin e majave biologjike përdoren vetëm substrate të prodhuara në rrugë biologjike. Produkte dhe substanca të tjera përdoren vetëm nëse përcaktohen për t'u përdorur në prodhimin biologjik, sipas nenit 22 të këtij ligji.

2. Majaja jobiologjike nuk duhet të jetë e pranishme së bashku me majanë biologjike në ushqimin biologjik ose në ushqimin biologjik për kafshë.

Neni 22

Produktet dhe substancat e caktuara që përdoren në përpunimin e ushqimeve dhe kriteret e përdorimit të tyre

1. Në prodhimin biologjik përdoren produktet dhe substancat që përfshihen në listën e produkteve dhe substancave të përcaktuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji.

2. Lista e produkteve dhe substancave, të cilat mund të përdoren në përpunimin e ushqimeve sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përdorimi i produkteve e substancave në prodhimin biologjik dhe përfshirja e tyre në listën e



produkteve e substancave të përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, bëhet sipas objektivave dhe parimeve të përcaktuara në kreun II dhe këtyre kritereve:

a) nëse nuk ka alternativa të përcaktuara në përputhje me këtë kapitull;

b) nëse pa përdorimin e tyre është e pamundur të prodhohen apo ruhen ushqimet ose të plotësohen kërkesat e caktuara dietike, të vendosura në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Produktet dhe substancat e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, duhet të gjenden në natyrë dhe mund t’u jenë nënshtruar vetëm proceseve mekanike, fizike, biologjike, enzimatike ose mikrobike, përveç rasteve kur këto produkte dhe substanca, nga burime të tilla, nuk gjenden në treg në sasi ose cilësi të mjaftueshme.

SESIONI 5 PËRSHTATSHMËRIA

Neni 23

Rregulla përjashtuese të prodhimit

1. Në prodhimin biologjik, në kushte të veçanta, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhen përjashtime nga rregullat e prodhimit, të përcaktuara nga seksionet 1 deri në 4, të këtij kreu.

2. Përjashtimet, sipas pikës 1, të këtij neni, zbatohen vetëm të kufizuara në kohë dhe për rastet e mëposhtme:

a) kur janë të nevojshme për të siguruar fillimin apo vazhdimësinë e prodhimit biologjik në ferma që përballen me kushtëzime klimatike, gjeografike ose strukturore;

b) kur janë të nevojshme për të siguruar furnizimin me ushqim për kafshë, farëra dhe material shumëzues vegjetativ, kafshë të gjalla e inpute të tjera bujqësore, kur inpute të tilla nuk gjenden në treg në formë biologjike;

c) kur janë të nevojshme për të siguruar furnizimin me përbërës me prejardhje bujqësore, kur këta përbërës nuk gjenden në treg në formë biologjike;

ç) kur janë të nevojshme për zgjidhjen e probleme specifike që lidhen me menaxhimin e blegtorisë biologjike;

d) kur, gjatë përpunimit, është e nevojshme të përdoren substanca dhe produkte specifike, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit

20, të këtij ligji, për të siguruar qëndrueshmëri në prodhimin e produkteve ushqimore biologjike;

dh) kur janë të nevojshme masa të përkohshme për të lejuar vazhdimin e prodhimit biologjik ose rifillimin e tij në rast të situatave të jashtëzakonshme (kushtet meteorologjike, shpërthimi i sëmundjeve infektive, ndotja me substanca toksike ose zjarreve);

e) kur është i nevojshëm përdorimi i aditivëve ushqimorë e substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, ose aditivëve të ushqimit për kafshë e substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 16, të këtij ligji, dhe kur këto substanca nuk gjenden në treg, përveçse të prodhuara nga OMGJ-të;

ë) kur përdorimi i aditivëve ushqimorë dhe substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 20, ose aditivëve të ushqimit për kafshë, sipas përcaktimit të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 16, të këtij ligji, përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 24

Rregulla të hollësishme dhe rregulla përjashtuese të prodhimit

Rregullat e hollësishme për prodhimin e ushqimeve biologjike të përpunuara për kafshë, ushqimeve biologjike të përpunuara dhe majave biologjike, sipas neneve 19, 20 e 21, si dhe rregullat e hollësishme përjashtuese të prodhimit për çdo rast, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

KREU IV ETIKETIMI

Neni 25

Përdorimi i termave që i referohen prodhimit biologjik

1. Për qëllim të këtij ligji, një produkt konsiderohet që i bart termat që i referohen metodave biologjike të prodhimit kur në etiketim, reklamë ose dokumente tregtare përbërësit e tij ose lëndët e para të ushqimit për kafshë përkruhen me terma që informojnë konsumatorin se produkti, përbërësit e tij ose lëndët e para për ushqim për kafshë janë përfunduar në përputhje me rregullat e



përcaktuara në këtë ligj. Në veçanti, termi “biologjik” ose “organik” dhe shkurtime si “bio” dhe “eko” përdoren të vetme ose të kombinuara për etiketimin dhe reklamën e produkteve që plotësojnë kërkesat e këtij ligji. Në etiketimin dhe reklamën e produkteve bujqësore të gjalla ose të papërpunuara, termat që i referohen metodës biologjike të prodhimit përdoren vetëm nëse edhe të gjithë përbërësit e këtij produkti janë prodhuar sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk përdoren në etiketim, reklamë dhe në dokumentet tregtare të produkteve që nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, përveçse kur ato nuk përdoren për produkte bujqësore ushqimore ose për ushqime për kafshë apo kur ato nuk kanë asnjë lidhje me prodhimin biologjik. Në etiketimet apo reklamën e prodhimit biologjik nuk përdoren terma, përfshirë edhe termat që përdoren në markat tregtare, praktikën që mund të keqinformojnë konsumatorin ose përdoruesin, duke sugjeruar se një produkt ose përbërësi i tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk përdoren për një produkt, për të cilin tregohet në etiketë ose reklamë se përmban OMGJ, përbëhet nga OMGJ ose prodhohet nga OMGJ, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për ushqimet e përpunuara, termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përdoren:

a) në emërtimin e produkteve për shitje, me kusht që:

i) ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji;

ii) të paktën 95 për qind e peshës së përbërësve të tij me prejardhje bujqësore të jenë biologjike.

b) vetëm në listën e përbërësve, me kusht që ushqimi të jetë në përputhje me nenin 20, pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të këtij ligji;

c) në listën e përbërësve dhe në të njëjtën fushëpamje me përshkrimin e produktit për shitje, me kusht që:

i) përbërësi kryesor të jetë një produkt gjuetie ose peshkimi;

ii) të përmbajë përbërës të tjerë me prejardhje bujqësore, të cilët janë të gjithë biologjike;

iii) ushqimi të plotësojë kërkesat e nenit 20, pika 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “ç”, të këtij ligji.

5. Lista e përbërësve tregon se cilët përbërës janë biologjikë. Në rastet kur zbatohen shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, të këtij neni, referimet ndaj metodës së prodhimit biologjik vendosen vetëm për përbërësit biologjikë dhe lista e përbërësve përfshin treguesin e përqindjes së përgjithshme të përbërësve biologjikë në raport me sasinë e përgjithshme të përbërësve me prejardhje bujqësore. Termat dhe treguesi i përqindjes, të përmendura më sipër, paraqiten me shkronja me të njëjtën ngjyrë, madhësi e formë shkrimi si treguesit e tjerë në listën e përbërësve.

Neni 26

Treguesit e detyrueshëm të etiketimit

1. Kur përdoren termat, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 25, të këtij ligji, duhet që:

a) në etiketë të vendoset edhe emri dhe numri me të cilët është miratuar trupa e kontrollit, subjekt i së cilës ka qenë operatori që ka kryer prodhimin ose përgatitjen e fundit;

b) në ambalazhin e ushqimeve të paraambalazhura duhet të vendoset dukshëm logoja kombëtare, e përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 27, të këtij ligji;

c) krahas logos kombëtare, në të njëjtin pozicion, vendoset edhe një tregues i vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore, prej të cilave përbëhet produkti dhe, sipas rastit, në një nga format e mëposhtme:

i) “Bujqësi shqiptarë”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në Shqipëri;

ii) “Bujqësi joshqiptarë”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në vende të tjera;

iii) “Bujqësi shqiptarë/joshqiptarë”, kur një pjesë e lëndëve të para bujqësore janë kultivuar në Shqipëri dhe një pjesë në një vend tjetër.

2. Treguesi “shqiptarë/joshqiptarë”, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, mund të zëvendësohet ose plotësohet me vendin, në rastin kur të gjitha lëndët e para bujqësore, nga i cili përbëhet produkti, janë kultivuar në atë vend. Për treguesin “Bujqësi shqiptarë/joshqiptarë”, sasinë e vogla në peshë të përbërësve nuk merren parasysh kur sasia e përgjithshme e këtyre përbërësve nuk kalon 2 për qind të peshës së përgjithshme të përbërësve me prejardhje bujqësore.



Treguesi “shqiptare/joshqiptare” nuk duhet të paraqitet me shkronja me ngjyra, përmasa dhe stil që e bëjnë më të dukshëm, krahasuar me emërtimin për shitje të produktit.

3. Treguesi i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset në një vend të dukshëm, që të shihet lehtësisht, të lexohet qartësisht dhe të mos fshihet.

Neni 27

Logot e prodhimit biologjik

1. Logoja kombëtare e prodhimit biologjik përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamën e produkteve që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Logoja nuk përdoret në rastin e produkteve dhe ushqimeve në kalim dhe të ushqimeve sipas përcaktimit në shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, të nenit 25, të këtij ligji.

2. Krahas logos kombëtare në etiketimin, paraqitjen dhe reklamën e produkteve që përmbushin kërkesat e këtij ligji, mund të përdoren edhe logo të tjera private.

Neni 28

Kërkesat e veçanta të etiketimit

Rregullat e veçanta për etiketimin dhe përmbajtjen e tij zbatohen për produktet e mëposhtme:

- a) ushqimin biologjik për kafshë;
- b) produktet me origjinë bimore në kalim;
- c) materialin shumëzues vegjetativ dhe farërat për kultivim.

Neni 29

Rregulla të hollësishme për etiketimin

Rregullat e hollësishme për etiketimin, paraqitjen, përbërjen dhe përmasat e treguesve të detyrueshëm të etiketimit, sipas neneve 25, 26 e 28, dhe rregullat për përbërjen, paraqitjen, madhësinë dhe dizajnimin e logos kombëtare për prodhimin biologjik, sipas nenit 27, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

KREU V KONTROLLET

Neni 30

Sistemi i kontrollit

1. Ky ligj përcakton sistemin e kontrollit, autoritetin kompetent dhe autoritetet përgjegjëse

për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit.

2. Sistemi i kontrollit, përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar të ushqimit, duhet, të paktën, të zbatojë masat parandaluese dhe të kontrollit për prodhimet biologjike, të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.

3. Natyra dhe shpeshësia e kontrolleve përcaktohen bazuar në vlerësimin e rrezikut të shfaqjes së parregullsive dhe shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

4. Të gjithë operatorët, me përjashtim të operatorëve të tregimit me shumicë, që tregtojnë vetëm produkte të paraambalazuara dhe operatorët, të cilët u tregtojnë konsumatorëve të fundit ose përdoruesve, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 34, të këtij ligji, i nënshtrohen sistemit të kontrollit për respektimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj, të paktën, një herë në vit.

5. Sistemi i kontrollit siguron gjurmueshmërinë për çdo produkt, në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushqimin, që të garantojë konsumatorët se produktet biologjike janë prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 31

Trupat e kontrollit

1. Trupat e kontrollit kryejnë inspektimin dhe certifikimin e operatorëve të prodhimit biologjik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Trupat e kontrollit miratohen vetëm nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe, në veçanti, kur:

a) ka një përshkrim të saktë të detyrave që kryen trupa e kontrollit dhe kushteve në të cilat mund t'i kryejë ato;

b) është e provuar që trupa e kontrollit:

i) zotëron përvojën, pajisjet dhe infrastrukturën e duhur për të kryer këto detyra;

ii) ka numër të mjaftueshëm personeli me kualifikimin dhe përvojën e duhur;

iii) është e paanshme dhe nuk ka konflikt interesi për të ushtruar këtë detyrë.

c) trupa e kontrollit është e akredituar në përputhje me standardin ISO/IEC 17065 për fushën e këtij ligji;



ç) ka një procedurë standarde për kontrollin që duhet të ndiqet, e cila përmban një përshkrim të detajuar të masave të kontrollit dhe masave paraprake, që trupa ushtron ndaj operatorëve nën kontrollin e saj;

d) ka një procedurë masash që ndërmerr trupa e kontrollit në rastet e parregullsive dhe/ose shkeljeve të përcaktuara në katalogun e sanksioneve, bazuar në standardin ISO/IEC 17065.

3. Trupa e kontrollit duhet të sigurojë që:

a) kontrollet e kryera të jenë objektive, të pavarura dhe efektive;

b) të zbatohen masa korrigjuese kur gjendet një parregullsi apo shkelje tek operatori.

4. Trupat e kontrollit i lejojnë autoritetit kompetent hyrjen në zyrat dhe ambientet e tyre dhe i sigurojnë çfarëdolloj informacioni dhe ndihme që konsiderohet e nevojshme.

5. Trupa e kontrollit i paraqet rregullisht autoritetit kompetent rezultatet e kontrolleve të kryera dhe sa herë që i kërkohet. Nëse rezultatet e kontrolleve tregojnë parregullsi, mospërputhje apo dyshim për parregullsi, të cilat cenojnë statusin e produktit biologjik, trupa e kontrollit duhet të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent, i cili merr masat e nevojshme.

6. Çdo vit, jo më vonë se data 31 janar, trupat e kontrollit i paraqesin autoritetit kompetent listën e operatorëve të kontrolluar prej tyre deri më 31 dhjetor të vitit të mëparshëm dhe, brenda datës 31 mars të çdo viti, raportin vjetor të aktiviteteve të kontrollit, të kryera gjatë vitit të mëparshëm.

7. Trupat e kontrollit nuk mund të kryejnë funksionet e mëposhtme:

a) mbikëqyrjen dhe auditimin e trupave të tjera të kontrollit;

b) kompetencën për të përcaktuar përjashtime, sipas nenit 23, të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet në kushte të veçanta, të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

8. Kriteret dhe procedurat e hollësishme të miratimit të trupave të kontrollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 32

Miratimi dhe mbikëqyrja e trupave të kontrollit

1. Në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë ngrihet dhe funksionon Komisioni për Prodhimin

Biologjik (KPB), i cili është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit.

2. Në ministri ngrihet njësi për prodhimin biologjik, e cila kryen mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për llogari të KPB-së dhe i raporton atij.

3. Përbërja, funksionimi, organizimi dhe detyrat e KPB-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 33

Rregullat e hollësishme për kontrollin

Rregullat e hollësishme për kontrollin e produkteve biologjike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 34

Përfshirja në sistemin e kontrollit

1. Çdo operator që prodhon, përgatit, ruan, importon ose eksporton nga/në një vend tjetër produktet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji, ose tregton këto produkte, përpara vendosjes në treg të produktit biologjik apo në kalim drejt produktit biologjik duhet:

a) të njoftojë aktivitetin e tij pranë autoritetit kompetent;

b) t'ia nënshtrojë aktivitetin e tij sistemit të kontrollit, të përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji.

2. Në rastet kur operatori i nënkontraktton një aktivitet një pale të tretë, nënkontraktori duhet të zbatojë kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Përfshihen nga zbatimi i këtij neni operatorët që i shesin produktet direkt te konsumatori ose përdoruesi i fundit, me kusht që të mos prodhojnë, përgatisin, magazinonjë, importojnë produkte të tilla nga një vend tjetër dhe që nuk kanë kontraktuar aktivitete të tilla për një palë të tretë.

4. Njësia e prodhimit biologjik pranon njoftimet dhe mban regjistrin e operatorëve të prodhimit biologjik.

5. Autoriteti kompetent siguron që çdo operator, i cili i përmbush kërkesat e këtij ligji dhe kryen pagesën ndaj trupës së kontrollit për kontrollin dhe procedurën e certifikimit, të përfshihet në sistemin e kontrollit për certifikim.

6. Trupat e kontrollit mbajnë një listë të përditësuar, e cila përmban emrat dhe adresat e



operatorëve që kontrollohen prej tyre. Kjo listë duhet të publikohet në internet, që të jetë në dispozicion të palëve të interesuara.

Neni 35

Certifikata e operatorit

1. Trupat e kontrollit, të përcaktuara sipas nenit 31, të këtij ligji, i lëshojnë certifikatën çdo operatori të kontrolluar prej tyre, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Certifikata duhet të përmbajë të dhënat për identifikimin e operatorit, llojin ose gamën e produkteve, si dhe periudhën e vlefshmërisë.

2. Operatori duhet të verifikojë certifikatën e operatorit që e furnizon atë.

Neni 36

Rregullat për njoftimin e aktivitetit

Rregullat e detajuara për procedurën e njoftimit të aktivitetit nga operatorët, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 34, dhe forma e certifikatës së operatorit, sipas nenit 35, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

KREU VI

TREGTIA ME VENDET E TJERA

Neni 37

Rregullat e importit të produkteve biologjike

1. Një produkt biologjik, i prodhuar në një vend tjetër, vendoset në tregun e vendit tonë nëse importuesi, i cili ka njoftuar aktivitetin e tij, sipas nenit 34, të këtij ligji, siguron që ky produkt është prodhuar në përputhje me rregullat ekuivalente.

2. Produktet e certifikuara nga trupa e kontrollit të vendeve anëtare të Bashkimit Europian ose të njohura si ekuivalente nga Komisioni Europian, konsiderohen ekuivalente, në kuadër të këtij ligji.

3. Rregullat e hollësishme dhe kushtet për importin e produkteve biologjike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

KREU VII
INFORMIMI

Neni 38

Shkëmbimi i informacionit

Për të garantuar se një produkt është prodhuar në përputhje me këtë ligj, autoriteti kompetent,

komisioni i prodhimit biologjik, trupat e kontrollit dhe autoriteti kombëtar i ushqimit duhet të shkëmbejnë informacionet për rezultatet e kontrolleve të kryera, sa herë të jetë e nevojshme.

Neni 39

Informacioni statistikor

1. Informacioni statistikor vjetor për prodhimin biologjik mbledhet dhe përpunohet nga sektori i statistikës në ministri dhe dërgohet për publikim në INSTAT.

2. Treguesit statistikorë për prodhimin biologjik përcaktohen sipas programit statistikor zyrtar. Forma dhe përmbajtja e informacionit statistikor përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE MASAT

Neni 40

Kundërvajtjet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative.

2. Nëse gjatë procesit të prodhimit të produkteve biologjike operatorët biologjikë shkelin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, trupat e kontrollit ndërmarrin masat, sipas katalogut të sanksioneve.

3. Përveç masave, sipas pikës 2, të këtij neni, në rastet e shkeljeve të rënda ose me ndikim të zgjatur, merren edhe këto masa:

a) kur në prodhimin biologjik përdoren produkte dhe substanca që nuk përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 16, të këtij ligji, produkti nuk certifikohet si biologjik;

b) në rast konstatimi të kontaminimit të produktit, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “nj”, të nenit 3, të këtij ligji, produkti nuk certifikohet si biologjik;

c) në rastin e gjetjes së një mashtrimi nga operatori, trupa e kontrollit i heq certifikatën operatorit;

ç) në rast se operatori përsërit mbi dy herë shkeljet, të cilat cenojnë statusin biologjik të produktit, operatorit i hiqet certifikata dhe nuk ka të drejtë aplikimi për një periudhë 12-mujore, nga data e heqjes së saj.



4. Trupës së kontrollit i hiqet miratimi kur:

- nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 31, të këtij ligji;
- nuk vazhdon të përmbushë kriteret e miratimit, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji;
- nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 31, të këtij ligji.

Neni 41

Ankimi

1. Kundër masave të përcaktuara në nenin 40, të këtij ligji, mund të bëhet ankim me shkrim tek autoriteti kompetent, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni për masën e vendosur.

2. Autoriteti kompetent duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Ekzekutimi i vendimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

KREU IX DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim neneve 13, 18, 24, 29, 31, 32, 33, 36 dhe 37, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, 16, 22 dhe 39, të këtij ligji.

Neni 43

Dispozita kalimtare

1. Deri në miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 9199, datë 26.2.2004, “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio””, për sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

2. Produktet dhe substancat e përdorura sipas ligjit nr. 9199, datë 26.2.2004, “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio””, por që nuk përfshihen në listën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 16 dhe në pikën 2, të nenit 22, të këtij ligji, mund të vazhdojnë të përdoren edhe 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Faqe | 22758

Neni 44

Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9199, datë 26.2.2004, “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio””, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9840, datë 9.11.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 107/2016

PËR PREFEKTIN E QARKUT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 114, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rolit të prefektit të qarkut, misionit të tij dhe kompetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Neni 2

Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e prefektit të qarkut me organet dhe institucionet e administratës shtetërore, me organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, degët territoriale që veprojnë në qark dhe me institucione të tjera shtetërore.



Neni 3 Misioni

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akte normative” janë aktet që nxirren nga organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, sipas ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të tyre, që i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga prefekti i qarkut, sipas këtij ligji.

2. “Degët territoriale” janë strukturat administrative të një ministrie ose të një institucioni të varësisë, që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësisve të vetëqeverisjes vendore detyra administrative, që mund të kryhen më mirë në territor, në përputhje me parimet e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. “Institucione të tjera shtetërore” janë institucionet dhe strukturat e Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të organeve të tjera në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative.

4. “Ministri” është ministri përgjegjës për veprimtarinë e prefektit të qarkut.

Neni 5 Emërimi dhe lirimi i prefektit

Prefekti i qarkut emërohet dhe lirohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 6 Kriteret e emërimit

Për të ushtruar detyrën e prefektit të qarkut, shtetasi duhet të plotësojë këto kriteret:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare, me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- të ketë 5 vjet përvojë pune në administratën publike;

ç) të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Neni 7 Papajtueshmëria e funksionit

1. Prefekti i qarkut nuk mund të jetë anëtar i Këshillit të Ministrave.

2. Funksioni i prefektit të qarkut është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik, me përjashtim të mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe të veprimtarive shkencore.

3. Prefekti i qarkut nuk mund të jetë drejtues në organizatat fitimprurëse ose anëtar i organeve drejtuese në një shoqëri tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këto ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit administrativ të prefektit të qarkut, me përjashtim të pjesëmarrjes në partitë politike ose të pjesëmarrjes në këto organe, për shkak të funksionit.

4. Prefekti i qarkut nuk mund të ushtrojë profesionin e avokatit, noterit, ekspertit të licencuar, konsulentit, agentit, përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni.

5. Prefekti i qarkut nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit administrativ të prefektit të qarkut.

Neni 8 Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut

Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

- verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që veprojnë në qark si dhe të këtyre degëve me organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore;
- raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që veprojnë në qark, sipas urdhrat të Kryeministrit, dhe, për



probleme të veçanta, sipas urdhrit të ministrit;

c) informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku;

d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;

dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;

e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;

ë) drejtimin ose pjesëmarrjen në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

f) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit;

g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;

gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;

h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;

i) bashkërendimin e punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor;

j) ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore.

KREU II

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 9

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore

1. Prefekti i qarkut për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave, Kryeministrit dhe ministrit.

2. Këshilli i Ministrave, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore i dërgojnë prefektit aktet e nxjerra, në të cilat caktohen detyra apo përcaktohen marrëdhënie në fushën e veprimtarisë së degës territoriale që vepron në qark.

3. Prefekti i qarkut, për veprimtarinë që mbulon, mund të propozojë pranë ministrave projektakte për zgjidhjen e problemeve të veprimtarisë së tyre.

4. Konfliktet që mund të lindin ndërmjet ministrave dhe prefektit zgjidhen nga Kryeministri.

Neni 10

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale

1. Për kryerjen e funksioneve në marrëdhënie me degët territoriale që veprojnë në qark, prefekti i qarkut ushtron përgjegjësitë e mëposhtme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj:

a) kontrollon dhe kërkon marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e degës përkatëse;

b) kërkon hartimin e planeve të zhvillimit dhe të projektbuxhetit vjetor, sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe u paraqet mendimet e tij ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore;

c) ndjek kërkesat dhe ankesat e shtetasve deri në zgjidhjen e tyre;

ç) kërkon të dhëna dhe informacione nga dega territoriale që vepron në qark, me përjashtim të rasteve kur ndalohet me ligj ose me akte nënligjore, për shkak të klasifikimit të informacionit të kërkuar. Degët territoriale që veprojnë në qark informojnë prefektin e qarkut për çështje, për të cilat kërkohet informacion;



d)harton çdo fund viti raportin mbi bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, dhe ua paraqet ministrive përgjegjëse dhe Kryeministrit.

2. Degët territoriale që veprojnë në qark dërgojnë kopje të planit të zhvillimit, të projektbuxhetit, të strukturës dhe të organikës te prefekti i qarkut.

Neni 11

Propozimet për emërim dhe lirim të drejtuesve të degëve territoriale

1. Emërimi dhe lirimi nga detyra i drejtuesve të degëve territoriale që veprojnë në qark bëhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me propozim të prefektit të qarkut, përveç rasteve kur ligji i posaçëm që rregullon marrëdhëniet e punës apo mënyrën e emërimit dhe të liritimit të tyre, e parashikon ndryshe.

2. Prefekti i qarkut i propozon ministrit përgjegjës ose drejtuesit të institucionit qendror përkatës emërimin ose lirimin e drejtuesit të degës territoriale që vepron në qark.

3. Propozimet për emërim duhet të bëhen me jo më pak se dy kandidatura.

4. Ministri përgjegjës ose titullari i institucionit qendror kthen përgjigje brenda 15 ditëve nga data e marrjes së propozimit. Në rast moskthimi të përgjigjes apo refuzimit të propozimit, prefekti i qarkut informon Kryeministrin.

Neni 12

Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit

1. Prefekti i qarkut bashkëpunon me organet e Policisë së Shtetit për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, në nivel qarku.

2. Prefekti i qarkut kërkon zbatimin e masave për ruajtjen e rendit, sipas përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

3. Prefekti i qarkut kërkon dhe merr rregullisht informacion nga drejtori i policisë vendore për problemet e rendit.

4. Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë dhe siguron mbështetjen e ndërsjellë të organeve të Policisë së Shtetit, të degëve territoriale që veprojnë në qark dhe të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Neni 13

Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes

Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin përkatës, prefekti i drejtohet ministrit të Mbrojtjes për angazhimin e njësisve të Forcave të Armatosura dhe kërkon mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave të emergjencave civile e të krizave.

Neni 14

Propozimi dhe drejtimi i task-forcave dhe organizmave të përkohshëm

1. Prefekti i qarkut drejton task-forcat e ngritura me akte ligjore e nënligjore dhe është përgjegjës për performancën e tyre, në nivel qarku.

2. Në çdo rast, kur në përbërje të task-forcave ka njësi të Forcave të Armatosura, ato drejtohen nga autoritetet ushtarake nëpërmjet zinxhirit të drejtimit e të komandimit, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

3. Prefekti i qarkut i propozon Kryeministrin dhe ministrit ngritjen e task-forcave dhe krijon organizma të përkohshëm në raste të veçanta, në nivel qarku.

4. Drejtuesit e degëve territoriale që veprojnë në qark dhe kryetarët e njësisve të vetëqeverisjes vendore, kur janë anëtarë të një task-force, kanë detyrimin të marrin pjesë dhe të zbatojnë detyrat e caktuara për këtë task-forcë, në zbatim të këtij ligji.

KREU III

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ORGANET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 15

Marrëdhëniet e prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore

1. Ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie.

2. Marrëdhëniet ndërmjet prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

3. Marrëdhëniet midis prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në këtë ligj dhe në ligjin për vetëqeverisjen vendore.



Neni 16

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

1. Zbatimi i akteve të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;

b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

ii) vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike;

iii) në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarinimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti;

iv) në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën “b”, nënparagrafi “i”, të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur

kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti i qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 17

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj.

2. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Neni 18

Verifikimi i përgjegjësive të deleguara

1. Prefekti i qarkut verifikon realizimin e funksioneve e të përgjegjësive të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Prefekti i qarkut verifikon përdorimin e fondeve, donacioneve apo kredive që rrjedhin nga marrëveshje të qeverisë me organizma ndërkombëtarë.

3. Në rast se gjatë verifikimit konstatohen shkelje ligjore, prefekti i qarkut informon ministrin, ministrin përgjegjës të funksioneve të deleguara, si dhe Kryeministrin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, dhe, kur është e nevojshme, u drejtohet organeve ligjzbatuese.

Neni 19

Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve

1. Prefekti i qarkut shqyrton ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Në këto raste, i kërkon organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore depozitimin e aktit përkatës te prefekti i qarkut, kur një gjë e tillë nuk është bërë më parë, ose zbaton procedurat e përcaktuara në nenin 16, të këtij ligji.



2. Ankesat e shtetasve shqyrtohen nga prefekti i qarkut sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Prefekti i qarkut informohet për konfliktet që lindin ndërmjet:

- a) institucioneve të ndryshme, në nivel qarku;
- b) institucioneve dhe shtetasve, në nivel qarku.

Në këto raste, prefekti i qarkut ka detyrim të përfshihet në zgjidhjen e tyre, duke adresuar konfliktin pranë institucioneve përgjegjëse.

KREU IV VENDIMMARRJA DHE ORGANIZIMI

Neni 20

Vendimarrja

1. Në zbatim të përgjegjësi të tij sipas këtij ligji, prefekti i qarkut nxjerr urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim.

2. Aktet e prefektit të qarkut bëhen të zbatueshme pas marrjes dijeni të subjekteve të cilave u drejtohen.

3. Në rastet kur lindin konflikte ndërmjet një ministrie ose drejtuesit të një institucioni qendror dhe prefektit të qarkut për urdhrat ose udhëzimet që ai ka nxjerrë, zgjidhja bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9, të këtij ligji.

4. Për rastet e konflikteve të subjekteve, të papërmendura në pikën 3, të këtij neni, dhe prefektit të qarkut, palës së interesuar i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative.

Neni 21

Administrata e prefektit të qarkut dhe burimet e financimit

1. Për ushtrimin e funksioneve e të përgjegjësi, prefekti i qarkut ka administratën e vet.

2. Struktura dhe organika e administratës së prefektit të qarkut miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

3. Detyrat e administratës së prefektit të qarkut, me propozim të ministrit, miratohen nga Kryeministri.

4. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të administratës së prefektit të qarkut rregullohen, në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

5. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë të administratës së prefektit të qarkut

rregullohen, sipas dispozitave të Kodit të Punës.

6. Administrata e prefektit të qarkut financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë e prefektit të qarkut.

Neni 22

Nënprefekti

1. Në mbështetje të veprimtarisë së prefektit të qarkut dhe në përbërje të administratës caktohen nënprefektët. Prefekti propozon caktimin e funksionit të nënprefektit për një ose më shumë bashki, në zbatim të ligjit për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

2. Nënprefekti emërohet apo lirohet, me propozim të prefektit të qarkut, nga ministri.

3. Nënprefekti për veprimtarinë e vet, për bashkinë/bashkitë përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut.

4. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve.

Neni 23

Organi këshillues pranë prefektit të qarkut

1. Pranë prefektit të qarkut funksionon organi këshillues i tij. Përbërja e këtij organi caktohet me urdhër të prefektit të qarkut.

2. Në organin këshillues marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive, drejtori i policisë vendore, drejtuesit e njësisë së Forcave të Armatosura për qarkun, drejtuesit e shërbimit shëndetësor, drejtuesit e drejtorisë arsimore rajonale, drejtuesit e drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, drejtues të tjerë të degëve territoriale që veprojnë në qark, të caktuar nga prefekti, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Organi këshillues mbledhet një herë në muaj për probleme të përgjegjësi të prefektit të qarkut, ku, për raste të veçanta, mund të thirren edhe specialistë të fushave përkatëse.

4. Rregullorja e funksionimit të organit këshillues miratohet nga prefekti i qarkut.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, të nxjerrë vendimin në zbatim të pikës 1, të nenit 18, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.



Neni 25
Shfuqizime

Ligji nr. 8927, datë 25.7.2002, “Për prefektin”, shfuqizohet.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9841, datë 9.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

REZOLUTË

PËR DËNIMIN E KRIMEVE TË KOMUNIZMIT NDAJ KLERIT, SI DHE MIRËNJOHJEN E VEÇANTË PËR ROLIN DHE VEPRIMTARINË E KLERIKËVE NË MBROJTJEN E VLERAVE DEMOKRATIKE DHE TË DREJTAVE E LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke u mbështetur në Rezolutën e Parlamentit Europian “Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin” (2009); Deklaratën e Pragës “Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin” (2008); Rezolutën 1096 (1996) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, si dhe Rezolutën 1481 (2006) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”;

Në vijim të Rezolutës nr. 11, datë 30.10.2006, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri”;

Duke riafirmuar dënimin e plotë e pa ekuivok të regjimit diktatorial komunist të ngritur nga Enver Hoxha dhe bashkëpunëtorët e tij;

Duke shprehur mirënjohje të thellë për punën intelektuale dhe vlerat e jashtëzakonshme njerëzore që kanë treguar klerikët gjatë regjimit komunist në ruajtjen dhe promovimin e besimit fetar;

Duke konfirmuar dënimin me ashpërsi të dhunimit masiv të të drejtave të njeriut ndaj klerikëve shqiptarë, të kryer nga regjimi komunist i

diktatorit Enver Hoxha, ku përfshihen edhe vrasjet (me dhe pa gjyq), vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet nga uria, tortura, puna skllavëruese, terrori fizik e psikologjik;

Duke vlerësuar lart kontributin, vlerat dhe sakrificat e të gjithë klerikëve të vrarë apo persekutuar gjatë regjimit diktatorial të Enver Hoxhës dhe duke u përlulur me mirënjohje të thellë ndaj veprës dhe punës së tyre për ruajtjen e besimit fetar dhe tolerancës fetare, e cila do t'i shërbejë ndërtimit të sotëm të një shoqërie të re dhe demokratike, që njeh dhe respekton lirinë e besimit dhe të drejtat e njeriut;

Duke mbajtur në konsideratë se sipas dokumenteve ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar aktet çnjerëzore të regjimit komunist ndaj klerikëve përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe ndjekja e dënimi i tyre nuk parashkruhet;

Duke e vlerësuar se zhvillimet politike dhe shoqërore të 25 viteve të tranzicionit, pavarësisht nga përpjekjet që kanë bërë qeveritë shqiptare për njohjen dhe promovimin e vlerave të besimit fetar, në funksion të tolerancës fetare, nuk kanë qenë të plotë, pasi nuk është bërë nxjerrja e plotë e së vërtetës mbi krimet e komunizmit, edhe ndaj klerit në Shqipëri, si dhe dënimi i ideatorëve, organizatorëve dhe zbatuesve të drejtpërdrejtë në aparatit represiv të regjimit diktatorial, në zbatim edhe të parimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare që i dënojnë krimet e komunizmit;

Duke qenë në dijeni të faktit se në 5 Nëntor 2016, në qytetin e Shkodrës, zhvillohet ceremonia e Lumturimit të disa klerikëve katolik shqiptarë të vrarë padrejtësisht nga regjimi komunist;

Deklaron me vendosmëri se:

1. Dënon fuqimisht diktatorin Enver Hoxha dhe regjimin totalitar komunist të instaluar prej tij së bashku me bashkëpunëtorët e vet, si dhe krimet e kryera prej tyre ndaj klerikëve shqiptarë.

2. Dënon fuqimisht vrasjen dhe persekutimin nga regjimi komunist dhe njeh me bindje të plotë pafajësinë e Dom Anton Zogaj, Imzot Frano Gjini, Marie Tuci, Atë Giovanni Fausti s.j., Vëlla Gjon Pantalia, Imzot Vincenc Prenushi o.f.m., Imzot Jul Bonati, Dom Alfons Tracki, Atë Gjon Shllaku, Atë Karl Serreqi, Atë Mati Prendushi, Dom Jozef Maksen, Dom Lazër Shantoja, Dom Lekë Sirdani, Dom Luigj Prendushi, Atë Ciprian Nika, Atë Serafin Koda, Atë Gaspër Suma, Dom Anton Muza, Dom Dedë Maçaj, Dom Dedë Malaj, Mark



Çuni, Atë Bernardin Pala, Atë Daniel Dajani, Gjelosh Lulashi, Dom Mikel Beltoja, Dom Ndre Zadeja, Dom Mark Gjani, Dom Dedë Plani, Fran Mirakaj, Dom Ejëll Deda, Qerim Sadiku, Dom Jak Bushati, Papa Josif Mihali, Dom Marin Shkurti, Dom Ndoc Suma, Dom Pjetër Çuni, Dom Shtjefën Kurti, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Sabri Koçi, Dede Reshat Bardhi, Haki Sharofi, Jonuz Bulaj, Vexhi Buharaja, Ismail Muçej, Haxhi Faik Sheh Qazim Hoxha, Hasan Tahsini, Baba Bedriu i Brerimës, Baba Hajro Progonati, Hafiz Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Lëngu, Hafiz Esat Myftia, Hafiz Musa Dërguti, Hafiz Ali Kraja, Imam Liman Shabani, Imam Met Troci, Sheh Ibrahim Karabunara, Sheh Myslim Luma, Baba Myrteza Kruja, Imam Ahmet Hyseni, Dervish Mehmet Verleni, Xhemal Naipi, Hafiz Sheuqet Boriçi, Hafiz Sabri Bushati, Molla Alush Zaganjori, Shejkh Hafiz Vehbi Sulejman Gavoçi, Selim Braja, Hafiz Bakalli, Hafiz Myrtja, Hafiz Muhamet Bekteshi, Sheh Ali Pazari, Sheh Reiz Sinani, Baba Ali Tomorri, Baba Qamil Gllava, Baba Shefqet Koshtani, Baba Bedri Cakrani, Dervish Ali Kocia, Dede Kamber Prishta, Baba Mehmet Zyka, Baba Islam Leskoviku, Baba Bajram Mahmutaj, Baba Islam Jangolli, Baba Ilmi Kurtesi, Dede Ahmet Myftari, Baba Sh. Cenametaj, Kryepiskop Visarioni Xhuvani, Kryehirësia e Tij Kristofor Kisi, Episkopi ndihmës i Apolonisë Irineu Banushi, Atë Gjergj Suli, Atë Aleksandër Lipe, Atë Dhimitër Leka, Atë Kostandin Bozdo, Atë Ligor Zografi, Atë Kosta Kole, Atë Thoma Vërleni, Atë Kristo Raci, Atë Jorgji Kosta, Atë Simon Tonini, Atë Ilia Zoto, Atë Gjergj Dedi etj.

3. Vlerëson me mirënjohje të thellë veprën, punën intelektuale dhe vlerat e jashtëzakonshme njerëzore të klerikëve shqiptarë gjatë regjimit

komunist për ruajtjen e besimit fetar dhe të tolerancës fetare, në funksion të ndërtimit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të një shoqërie të re dhe demokratike, që njeh dhe respekton lirinë e besimit dhe të drejtat e njeriut.

4. Vlerëson se klerikët që ishin viktimë e krimeve dhe persekutimeve të regjimit komunist, si dhe familjarët e tyre meritojnë rehabilitim, respekt dhe mirëkuptim për vuajtjen e tyre, si dhe mirënjohje për qëndresën e tyre ndaj sistemit më të egër diktatorial komunist në Europën Lindore.

5. Nxiti Qeverinë që të rrisë fondet financiare dhe përpjekjet për zbulimin e krimeve të komunizmit ndaj klerikëve në Shqipëri, autorëve të këtyre krimeve, si dhe rehabilitimin e familjarëve të viktimave, në vazhden e përpjekjeve që ka bërë shteti shqiptar, në funksion të rehabilitimit dhe integritetit të tyre në jetën sociale, ekonomike e politike.

6. Nxiti akademikët dhe historianët që të ndërmarrin veprimtari kërkimore-shkencore për përcaktimin dhe verifikimin objektiv të krimeve të komunizmit ndaj klerikëve në Shqipëri gjatë diktaturës komuniste, si dhe kërkon bërjen publike të të gjitha dokumenteve arkivore që dëshmojnë këto krime, nëpërmjet krijimit të mekanizmave të nevojshëm institucionalë, që do të bëjnë të mundur një evidentim real, bazuar mbi fakte dhe të dhëna konkrete të kohës.

Miraturar në datën 3.11.2016

KRYETARI
Ilir Meta

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë